

BASHKIA SHKODËR

BUXHETI 2026 DHE PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM

2027 - 2028

Vizioni ynë është “Shkodra qendër e rëndësishme kombëtare e rajonale, një bashki me cilësi të mire jetese për banorët e vet dhe mikpritëse për vizitorët”.

Bazuar në vizionin politik të kryetarit të bashkisë, puna e bashkisë Shkodër në vitet e ardhshme do të jetë e fokusuar në zhvillimin social dhe ekonomik të Shkodrës. Bashkia Shkodër do të jetë e përqëndrar tek puna si e vetmja mënyrë për ti kthyer Shkodrës shkëlqimin që meriton si një nga qendra më të rëndësishme ekonomike dhe kulturore të vendit.

Në këto vite do të përqëndrohemi në këto shtylla kryesore:

- **Forcimi i ekonomisë nëpërmjet tërheqjes dhe zbatimit të investimeve publike** të rëndësishme në territorin e bashkisë duke krijuar një mjedis tërheqës për nxjten e investimeve private dhe punësimit nga aktorë brenda e jashtë territorit të bashkisë.

Një sërë investimesh madhore për territorin e bashkisë sonë kanë filluar e do të vijojnë vitin e ardhshëm. Këto investime pavarësisht se mund të zhvillohen edhe nga aktorë të tjerë vec bashkisë do të kërkojnë një punë të madhe për përgatitjen, koordinimin, zbatimin dhe mbikqyrjen e tyre.

Ndër investimet kryesore të filluara ose në proces përgatitor janë:

Zgjerimi i Urës së Bahcallëkut dhe i rrugës Harku i Bërdicës-Ura e Bahcallëkut; Rruga e Dukagjinit; Parku i hyrjes së Shkodrës; Rruga Ura e Bunë Shirokë, Rikualifikimi i bregut Perëndimorë të Liqenit; rruga Shirokë-Zogaj; Teatri Migjeni, Kinema republika, Sistemi i Muzeve, Investime në infrastrukturën rrugore të qytetit dhe NJA kryesore, Rikualifikimi i blloqeve të banimit, shkolla dhe kopshtet publike, Ndërtimi i hapsirave rekreative dhe këndeve të lojrave, eficientia e energjisë në blloqet e pallateve, Rikualikimi i tregut të Zdrales, Impianti i Trajtimit të Ujrave të Zeza dhe Ujësjellësi Shkodër,.

- **Kthimi i bashkisë në punë** për t’iu përgjiur me intensitet nevojave të qytetarëve në qytet dhe zonat rurale. Për këtë arsye kemi ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm si:
 - o Krijimi i Ndërmarrjes të Punëve dhe Shërbimeve Publike dhe Drejtorinë e Mirembajtjes së Objekteve Publike ka dhënë tashmë rezultatet në intensifikimin e punës në mirëmbajtjen e mjedisve publike, rrugëve, trotuareve e gjelbërimit, mirëmbajtjes së shkollave, kopshteve e godinave të tjera publike, përmirësimi i sinjalistikës horizontale e vertikale, ndërtimi i rrjetit të bicikletave në të gjithë qytetin,
 - o Forcimi i burimeve njerëzore dhe infrastrukturës së bashkisë nëpërmjet riorganizimit
- **Shkodra e kulturës, sportit dhe turizmit** së pari si një politikë mireqenie për banorët por dhe si mjet për tërheqjen e vizitorëve.

- *Është përfunduar brandi, infot turistike dhe marketimi për bashkinë tonë.*
 - *Po fuqizojmë produkte specifike turistike*
 - *Është rritur buxheti për aktivitetet kulturore e sportive për të pasur në çdo sezon të vitit një apo dy evente madhore që tërheqin vizitorë në bashki, ndërkohë që përmirësojmë ndjeshëm infrastrukturën për evente kulturore dhe sportive.*
- ***Bashkia e hapur*** si një filozofi e re komunikimi me qytetarët dhe krijimi i një marrëdhënie të re transparence e besimi si bazë e domosdoshme për sukses.
- *Do të vazhdojmë politikën e “dyerve të hapura” të bashkisë si një vend eventesh si në sheshin përpara ashtu edhe brenda bashkisë në hollet e saj*
 - *Do të ndërtojmë një marrëdhënie më të ngushtë me qytetarët nepërmjet informimit të vazhdueshmë rreth politikave vendore.*
 - *Kemi ndërtuar procese pjesëmarrëse në të gjitha nismat e mëdha si plani i mobilitetit, rishikimi i planit vendor dhe investimet e tjera madhore.*
 - *Komunikim më i hapur dhe intensiv me të gjithë aktorët zhvillimorë si komuniteti i biznesit, këshillat rinorë, universitetin e shkollat e mesme, shoqërinë civile për të çuar përpara nisma të përbashkëta.*

HYRJE.....	5
1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM	5
1.1 SITUATA E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE	5
1.2 ÇËSHTJE KRYESORE PËR PROJEKTET DHE POLITIKAT E BASHKISË	12
1.3 INFORMACION FINANCIAR KRYESOR	13
2. ORIENTIMI AFATGJATË I BASHKISË.....	17
2.1 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT AFATGJATË/STRATEGJIA TERRITORIALE	17
2.2 SFIDAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT	22
2.3 PLANI I SHPENZIMEVE KAPITALE 2026 - 2028 NE 000/LEKE	23
3. INFORMACION FINANCIAR.....	26
3.1 BURIMI I TE ARDHURAVE	26
3.1.1 Të ardhurat e veta të bashkisë.	36
3.1.2 Burimet nga qeveria qendrore.....	66
3.2 SHPENZIMET	71
3.2.1 Analiza e shpenzimeve totale për vitet 2026–2028	74
3.2.2 Analiza e zërave kryesorë të shpenzimeve.....	74
3.2.3 Analiza për peshat specifike dhe kontributet kryesore të programeve dhe shpenzimeve	75
3.2.4 Relacion analitik sipas programeve buxhetore (2026–2028)	78
3.3 INFORMACION FINANCIAR SUPLEMENTAR	89
3.3.1 Huamarrja	89
3.3.2 Detyrimet e prapambetura	89
3.3.3 Analiza e risqeve dhe masat për përballimin e tyre	90
4. MONITORIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË NJËSISË	127
4.1 HYRJE — REZULTATI I PËRGJITHSHËM DHE PËRFUNDIME.....	127
4.3 INVESTIMET PUBLIKE STRATEGJIKE NË NIVEL VENDOR-	132

Lista e Tabelave

Tabela 1 Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë Shkodër	27
Tabela 2 Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit të financimit.....	30
Tabela 3 Të ardhurat e veta	38
Tabela 4 Të ardhurat e veta për vitet 2026-2028 sipas klasifikimit ekonomik	41
Tabela 5 Planifikimi i të ardhurave për vitet 2026-2028 sipas Njësive Administrative / mijë Lekë ..	43
Tabela 6 Të ardhurat nga taksat vendore	45
Tabela 7 Kapaciteti i ndërtesave të bizneseve sipas kategorizimit.....	47
Tabela 8 Kapaciteti i banesave të taksueshme.....	48
Tabela 9 Të dhena mesatare sipërfaqe e ndërtese për taksapagues sipas llojit, familjar dhe biznes ...	49
Tabela 10 Kapaciteti i tokës bujqësore të taksueshme, sipas kategorisë së bonitetit	49
Tabela 11 Efekti ekonomik i uljes së taksës së ndërtesës dhe tokës bujqësore	50
Tabela 12 Efekti i lehtësive fiskale të taksës së ndikimit në infrastrukturë	51
Tabela 13 Të ardhura nga Taksa e fjetjes në hotel	52
Tabela 14 Kapaciteti i taksapaguesve sipas grupimeve.....	54
Tabela 15 Kapaciteti i familjeve taksapaguese sipas grupimeve	55
Tabela 16 Kapaciteti i bizneseve dhe institucioneve taksapaguese.....	57
Tabela 17 Kapaciteti i bizneseve te vogla sipas natyres se tyre	59
Tabela 18 Kapaciteti i bizneseve te medha sipas natyres se tyre	59
Tabela 19 Efekti ekonomik i lehtësive tek pastrimi, ndriçimi dhe gjelbrimi për familjet.....	61
Tabela 20 Të ardhura nga tarifat për veprimtaritë në institucione të arsimit, kulturës, sportit, shërbimit social.....	63
Tabela 21 Transferta e pakushtëzuar	67

Tabela 22 Transferta e pakushtëzuar sektoriale	70
Tabela 23 Planifikimi i buxhetit për vitet 2026 -2028 sipas klasifikimit ekonomik	73
Tabela 24 Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike ne mije leke	78
Tabela 25 Shpenzimet totale faktike, të buxhetuara dhe të planifikuara të Bashkisë 2026-2028 ne mije leke	85
Tabela 26 Rezultati i buxhetit.....	89

HYRJE

1. Vështrim i përgjithshëm

1.1 Situata e njësisë së vetëqeverisjes vendore

Bashkia Shkodër është një nga bashkitë më të mëdha dhe më të rëndësishme të Shqipërisë, e vendosur në pjesën veri-perëndimore të vendit. Ajo shtrihet në një sipërfaqe prej 872.71 km² dhe ka një popullsi prej rreth 214,897 banorësh. Territori i bashkisë përfshin 11 njësi administrative: Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postrinë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh dhe Velipojë, të cilat përfshijnë një qytet dhe 92 fshatra me karakteristika të ndryshme gjeografike dhe ekonomike.



Pozita gjeografike e Bashkisë Shkodër përbën një nga faktorët kryesorë që përcakton potencialin e saj për zhvillim ekonomik, social dhe kulturor. Shkodra shtrihet nga Alpet Shqiptare në veri deri në bregdetin e Adriatikut në jugperëndim, duke përfshirë një territor të gjerë e të larmishëm që përfshin Liqenin e Shkodrës, lumenjtë Buna, Drin dhe Kir, si dhe zona fushore e kodrinore. Ky diversitet natyror krijon kushte të favorshme për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore, blegtorale, peshkimit, turizmit dhe industrisë së lehtë.

Pozita gjeografike dhe lidhjet infrastrukturore i japin Shkodrës një rëndësi të veçantë strategjike. Ajo ndodhet pranë kufirit me Malin e Zi dhe lidhet përmes rrugëve kombëtare e hekurudhore me qendrat kryesore të vendit dhe rajonit, çka e kthen në një nyje të rëndësishme ekonomike e tregtare në veri të Shqipërisë. Zona bregdetare e Velipojës dhe mjediset natyrore përreth Liqenit të Shkodrës ofrojnë mundësi të gjera për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, ekologjik dhe kulturor.

Përveç pasurive natyrore dhe potencialit ekonomik, Shkodra ka një trashëgimi historike dhe kulturore të pasur, duke qenë një nga qytetet më të vjetra dhe më me ndikim në zhvillimin e identitetit kombëtar. Qyteti njihet si “Djepi i Kulturës Shqiptare”, falë kontributit të tij në arsim, art, letërsi dhe në zhvillimin e jetës qytetare. Të gjitha këto karakteristika e bëjnë Bashkinë Shkodër një territor me potencial të lartë zhvillimi të qëndrueshëm, por njëkohësisht me sfida të rëndësishme që lidhen me menaxhimin e territorit, përmirësimin e shërbimeve publike dhe mbrojtjen e mjedisit.

Ndarja në Lagje dhe fshatra në Njësitë Administrative të Bashkisë së Shkodrës

Bashkia Shkodër	Nj.A	Fshatrat	Kufizimi Veri	Kufizimi Jug	Kufizimi Lindje	Kufizimi Perëndim
	Shkodër	Qyteti Shkodër 5 Lagje	Rrethina	Bërdicë, Guri i Zi	Rrethina, Guri i Zi	Liçeni i Shkodrës
	Ana e Malit	Oblikë, Babot, Muriqan, Shtuf, Dramosh, Oblikë esiperme, Obot, Vallas, Velinaj, Vidhgar	Shkodër	Lumi Buna Dajç	Rrethina	Mali i Zi
	Bërdicë	Bërdice e Madhe, Bërdice e Mesme, Bërdice e Siperme, Trush, Beltoje, Mali Hebjaj	Shkodër	Bushat	Guri i Zi Lumi Drin	Dajç
	Dajç	Dajç, Samrisht i Ri, Samrisht i Siperme, Belaj, Mali i Gjymtit, Pentar, Rrushkull, Mushan, Darragjat, Suka-Dajç, Shirq	Lumi Buna Ana e Malit Mali i Zi	Velipojë	Bërdicë Bushat	Lumi Buna
	Guri i Zi	Guri i Zi, Juban, Ganjollë, Kuç, Rrencë, Vukatanë, Gajtan, Rragam, Sheldi, Mazrek, Shpor	Postribë Shllak	Bushat Vau i Dejës	Vau i Dejës	Bërdicë Shkodër
	Postribë	Mes, Dragoç, Boks, Kullaj, Myselim, Drisht, Ura e shtrenjtë, Domen, Shakotë, Prekal, Vilëz	Pult Malësi e Madhe	Guri i Zi	Shllak	Rrethina
	Pult	Pog, Kir, Gjuraj, Plan, Xhan, Bruçaj, Mgull	Shalë Malësi e Madhe	Postribë Shllak	Shosh Shalë	Malësi e Madhe
	Rrethinat	Dobraç, Grudë e Re, ShtojiRi, Guci e Re, Shtoj i vjeter, Zues, Golem, HotiRi, Bleran, Bardhaj	Gruemirë	ShkodërGuri i Zi	Postribë	Liçeni Shkodër
	Shalë	Breg-Lumi, Abat, Nicaj-Shale, Lekaj, Vuksanaj, Pecaj, Theth, Nderlysaj, Gimaj, Nënnavriq, Lotaj	Kosove	Shosh Tropojë	Tropojë	Malësi e Madhe Pult
	Shosh	Ndrejaj, Nikaj-Shosh, Palaj, Pepsujaj, Brashtë	Shalë	Temal Shllak	Pult	Temal Tropoje Vau i Dejës
	Velipojë	Velipojë, Pulaj, Luarzë, Baks-Rrjoll, Gomsiqe, Baks i Ri, Reç i Ri, Ças, Mali Kolaj, Reç Pulaj	Dajç	Deti Adriatik	Lezhe	Lumi Buna


Tabela 1: Të dhëna mbi Bashkinë Shkodër

Nga këndvështrimi strukturor demografik në Bashkinë Shkodër ka një popullsi prej 214,897 banorë, sipas të dhënave më të fundit. Popullsia e saj karakterizohet nga një shpërndarje territoriale e ndarë ndërmjet zonave urbane dhe rurale, ku rreth 54.6% e banorëve jetojnë në zonat urbane dhe 45.4% në zonat rurale. Vërehet një qendërzim i lartë urban, në qytetin e Shkodrës si poli kryesor ekonomik, kulturor dhe administrativ. Dendësia mesatare e popullsisë rezulton të jetë rreth 246 banorë për km², ndësa përqendrimi më i madh i popullsisë është në qytetin e Shkodrës.

Tabela 1. Popullsia dhe numri i Familjeve në Njësitë Administrative të Bashkisë Shkodër

Bashkia	Njësia Administrative	Popullsia	Nr familje
Shkodër	Shkodër	117,334	39,157
	Ana Malit	6,187	1,718
	Berdicë	10,342	2,839
	Dajç	9,208	2,292
	Guri i Zi	12,376	3,564
	Postribë	11,968	3,509
	Pult	2,941	935
	Rrethinat	29,522	8,625
	Shalë	4851	1688
	Shosh		
	Velipojë	10,168	2,840
	Totali	214,897	67,167

Parë nga këndvështrimi i raportit gjinor, popullsia e Bashkisë Shkodër ruan një diferencë të lehtë përsa i përket ndarjes gjinore të popullsisë, në meshkuj e femra duke shprehur një situatë gjinore pothuaj të balancuar.



Burim i informacionit: Gjendja Civile Shkodër.

Zhvillimi ekonomik

Bashkia Shkodër karakterizohet nga një shumëllojshmëri aktivitetesh ekonomike që përfshijnë sektorë si industria, energjia, turizmi dhe zonat ekonomike. Ekonomia lokale mbështetet kryesisht në ndërmarrjet e vogla, të cilat përbëjnë bazën kryesore të zhvillimit ekonomik dhe të punësimit në territorin e bashkisë. Krijimi dhe konsolidimi i këtyre bizneseve përfaqëson një potencial të rëndësishëm për rritjen e qëndrueshme ekonomike, zhvillimin e tregut të punës dhe rritjen e të ardhurave vendore. Ndër aktivitetet kryesore ekonomike janë industria e lehtë prodhuese, përpunimi dhe prodhimi i materialeve tekstile, si edhe tregtia dhe shërbimet.

Po ashtu, Bashkia Shkodër përbën një nga zonat më të rëndësishme në vend për nga potenciali bujqësor dhe blegtoral. Falë tokave pjellore dhe traditës së konsoliduar në kultivimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, janë zhvilluar biznese të shumta agro-përpunuese që luajnë një rol kyç në zinxhirin ekonomik lokal dhe në garantimin e punësimit në zonat rurale.

Një tjetër element me rëndësi është prania e zonës industriale në Shkodër, në të cilën janë përqëndruar biznese të mëdha përpunuese është një tjetër element me rëndësi në zhvillimin ekonomik, duke ofruar punësim dhe të ardhura për popullsinë. Ndërmarrjet që merren me prodhimin dhe përpunimin e tekstileve, këpucëve dhe industrisë së lehtë kanë zhvilluar aktivitetet e tyre në këtë zonë, duke kontribuar ndjeshën në ekonominë lokale.

Aktualisht, subjektet ekonomike që operojnë në territorin e Bashkisë Shkodër janë të shpërndara në sektorët kryesorë si më poshtë:

Spektori	Përshkrimi i veprimtarisë
Ndertim	Përfshin aktivitetet e ndërtimit të banesave, infrastrukturës dhe objekteve të tjera publike e private.
Prodhim	Përfshin bizneset që merren me prodhimin e tekstileve, këpucëve, përpunimin e metaleve dhe industrinë ushqimore.
Sherbime	Bizneset që ofrojnë shërbime në fushat e transportit, hotelerisë, turizmit, arsimit dhe shëndetësisë.
Transport	Bizneset që operojnë në transportin urban, ndërrurban dhe të mallrave
Tregti	Përfshin tregtinë me shumicë dhe pakicë të produkteve ushqimore, industriale dhe bujqësore.

Burim i informacionit: Drejtoria Rajonale Tatimore, Shkodër

Artizanati - Një tjetër element që pasuron ekonominë vendore është artizanati, i cili ka rrënjë të thella në historinë e qytetit të Shkodrës. Ky sektor vazhdon të jetë aktiv, duke kontribuar si në ruajtjen e vlerave kulturore ashtu edhe në krijimin e mundësive për punësim dhe diversifikimin e ekonomisë lokale.

Turizmi: Bashkia Shkodër karakterizohet nga një shumëllojshmëri atraksionesh turistike, nga bukuritë natyrore deri te ndërtesat historike dhe identitetet kulturore. Traditat njerëzore,

kulturore dhe historike i shtojnë më shumë vlerë këtij potenciali. Llojet kryesore të turizmit janë: turizmi malor (Jezerca, Parku Kombëtar i Thethit), turizmi bregdetar (plazhi i Velipojës), turizmi lumor (lumi i Bunës, Kirit, Drinit, Shalës), turizmi liqenor (Liqeni i Shkodrës), dhe turizmi qytetar që bazohet në monumentet fetare, shtëpitë tradicionale dhe monumentet historike të qytetit të Shkodrës si dhe jeta kulturore dhe artistike e gjallë.

Në vitet e fundit, Shkodra ka përjetuar një rritje të qëndrueshme dhe të ndjeshme të sektorit turistik. Ajo po konsolidohet gjithnjë e më shumë si një destinacion i preferuar për pushuesit vendas dhe të huaj. Sipas të dhënave të raportuara, në vitin 2022, në Shkodër u regjistruan rreth 264 mijë net akomodimi, ndërsa në tetor 2025, ky numër ka tejkaluar 500 mijë, duke reflektuar një trefishim të vizitave krahasuar me vitin 2022. Kjo rritje është vërejtur si gjatë sezonit veror, por edhe jashtë tij. Këto tregues konfirmojnë Shkodrën si një qendër turistike e rëndësishme në Shqipëri dhe rajon, me një rritje të qëndrueshme të vizitorëve dhe të bizneseve të turizmit. Atraktiviteti historik, kulturor dhe natyror i qytetit, së bashku me zgjerimin e ofertës akomoduese, e pozicionojnë Shkodrën si një destinacion tërheqës për zhvillim të mëtejshëm turistik.


Forca punëtore dhe papunësisë

Forca punëtore përbën pjesën e popullsisë që është në moshë pune dhe që zotëron aftësitë fizike, intelektuale dhe profesionale për t'u angazhuar në veprimtari ekonomike. Brenda saj, popullsia ekonomisht aktive përfshin të gjithë individët që janë të punësuar, si dhe ata që janë të papunë, por që kërkojnë në mënyrë aktive punë dhe janë të gatshëm të punojnë. Ky tregues paraqet një rëndësi të veçantë për analizimin e dinamikës së tregut të punës.

Nga ana tjetër, papunësia përfaqëson një nga sfidat më të rëndësishme ekonomike dhe sociale të shoqërisë moderne. Ajo pasqyron mospërputhjet ndërmjet ofertës dhe kërkesës për fuqi punëtore dhe analiza e saj është thelbësore për të kuptuar vështirësitë aktuale të tregut të punës, si edhe për të parashikuar zhvillimet e ardhshme ekonomike e shoqërore.

Prandaj, monitorimi i vazhdueshëm i treguesve të fuqisë punëtore, shkallës së pjesëmarrjes në tregun e punës dhe strukturës profesionale, ofron bazën për hartimin e strategjive të qëndrueshme të zhvillimit ekonomik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.


Punësimi: Bazuar në të dhënat marra nga Drejtoria Rajonale e Punësimit Shkodër për periudhën janar - shtator 2025 rezulton se numri i të punësuarve në Bashkinë Shkodër është 1,190 persona, nga të cilët 710 janë femra, që përbëjnë rreth 60% të totalit të punësuar. Ky tregues reflekton një përfshirje të konsiderueshme të grave në tregun e punës dhe në aktivitetet ekonomike vendore.



Referuar të dhënave analiza e strukturës së punësimit sipas grupmoshave tregon se për popullsinë në moshë pune 15-29 vjeç numri i të punësuarve është 464 persona, gjë e cila nënvizon pjesëmarrjen e të rinjve në tregun e punës. Grupmosha 20–24 vjeç përfaqëson pjesën më të madhe të të punësuarve, me 235 persona ose rreth 19,7% të totalit, duke reflektuar përfshirjen e të rinjve që hyjnë për herë të parë në tregun e punës. Grupmosha 25–29 vjeç renditet e dyta me 193 të punësuar (16,2%), çka tregon se pjesëmarrja e të rinjve në tregun e punës mbetet e rëndësishme edhe në fazat e hershme të karrierës profesionale. Ndërsa, numri i të punësuarve për grupmoshën mbi 50 vjeç është 285 persona.

Përsa i përket analizës së nivelit arsimor të të punësuarve, ajo evidenton një përqendrim të lartë në nivelet e arsimit të mesëm dhe një pjesëmarrje të konsiderueshme në arsimin e lartë. Pjesa më e madhe e të punësuarve, rreth 32%, kanë përfunduar arsimin 9-vjeçar, ndërsa 26.5% kanë përfunduar gjimnazin. Në kategorinë e arsimit të lartë, përfshirë programet Bachelor dhe Master, përqindja arrin rreth 33% të totalit.

Papunësia: Numri i të papunëve për grupmoshën 19-64 vjeç vlerësohet të jetë 2740 persona, referuar të dhënave analiza e strukturës së papunësisë sipas grupmoshave tregon se shkalla e papunësisë për popullsinë në moshë pune 15-29 vjeç është 816. Në anën tjetër, numri i të papunëve të regjistruar për grupmoshën mbi 50 vjeç është më e lartë, gjë e cila reflekton sfidat për t'u riintegruar në tregun e punës. Përsa i përket strukturës gjinore të papunësisë ajo është pothuajse e barabartë midis femrave dhe burrave (50.5 % femra dhe 45.5 % burra).



VLP-ve të shpallura sipas aktiviteteve ekonomike: Në total vendet e punës të shpallura të lira për secilin sektor ekonomik arrijnë në 2,653 vende nga të cilat, industria përpunuese përbën rreth 35% të tyre, duke qenë sektori dominues në rajonin e Shkodrës. Nga ana tjetër, sektori i akomodimit dhe shërbimit ushqimor kontribuon me 10% të totalit. Sektori i tregtisë përbën rreth 6.3%, ndërsa informacioni dhe komunikimi përbëjnë 5.6% të vendeve të punës të shpallura.

1.2 Çështje kryesore për projektet dhe politikat e bashkisë

Burimi i informacionit: PPV/PZhS

Bashkia Shkodër ndjek një skenar policentrik të zhvillimit territorial, i cili synon të krijojë një strukturë të ekuilibruar hapësinore dhe të forcojë kohezionin territorial në të gjithë bashkinë. Ky koncept zhvillohet në dy nivele: në nivel bashkiak, fokusi është tek krijimi dhe forcimi i qendrave lokale për ofrimin e shërbimeve bazë, si arsimi, shëndetësia, posta dhe infrastruktura sociale, duke rritur aksesin për komunitetet dhe duke ulur varësinë nga qendra kryesore urbane. Ndërsa në nivel qyteti, theksi vendoset tek shpërndarja e barabartë e shërbimeve dhe aktiviteteve brenda territorit urban, përmes zhvillimit të qendrave të reja rreth bërthamës historike të qytetit, që konsolidojnë strukturën ekzistuese urbane pa cenuar tipologjitë historike të ndërtimit dhe identitetin urban të Shkodrës.

Në zonat rurale, parashikohet përmirësimi i qendrave ekzistuese dhe zhvillimi i infrastrukturës bazë për të mbështetur jetesën e komuniteteve dhe zhvillimin ekonomik lokal, duke përfshirë

investime në rrjetin rrugor, furnizimin me ujë, kanalizimet dhe energjinë, si dhe infrastrukturën sociale. Qasja policentrike synon gjithashtu të ruajë tokën bujqësore dhe burimet natyrore, duke kufizuar shpërhapjen e pakontrolluar të ndërtimit dhe duke nxitur kompaktësimin e zhvillimit brenda qendrave ekzistuese. Kjo strategji nxit edhe zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme, duke promovuar ndërveprimin mes sektorëve të ndryshëm, përfshirë industrinë, turizmin, bujqësinë dhe artizanatin lokal, duke mbështetur një ekonomi të shumëdimensionale që kontribuon në zhvillimin rajonal.

Në kuadër të këtij skenari krijohet një hierarki qendrash, ku qyteti Shkodër vepron si qendër primare urbane, ndërsa qendrat lokale dhe rurale ofrojnë shërbime bazë për komunitetin dhe luajnë rol kyç në shpërndarjen e mundësive ekonomike dhe shërbimeve publike. Njëkohësisht, ky model zhvillimi garanton mbrojtjen e burimeve natyrore dhe ujore, duke lehtësuar zhvillimin e turizmit gjithëvjetor në përputhje me parashikimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar (PPK) dhe Planit Ndërsektorial të Zonës së Veriut (PINS), duke promovuar balancimin e zhvillimit ekonomik me ruajtjen e mjedisit dhe resurseve natyrore. Përmes këtij skenari, Bashkia Shkodër synon të sigurojë një zhvillim territorial të qëndrueshëm, i cili mbështet kohezionin social, rrit cilësinë e jetës për qytetarët dhe forcon potencialin ekonomik dhe turistik të rajonit.

1.3 Informacion financiar kryesor

1.3.1 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së.

Hartimi i projektit buxhetor afatmesëm 2026 - 2028 është bere bazuar në ligjin nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore“, të ndryshuar, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar , ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjin 68/2017 date 27.4.2017 “ Per financat e veteqeverisjes vendore “ , udhezimit të Ministrise se Financave dhe Ekonomisë nr. 23 date 30.07.2018 “ Per procedurat standarte te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem te NJQV” , udhezimit plotesues 8 date 28.02.2025 të Ministrise se Financave dhe Ekonomisë “ *Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2026 - 2028* ” dhe dhe shtojcat plotesuese; Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 9 datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit te buxhetit*” te ndryshuar ;

Këshilli Bashkiak me VKB nr. 73 date 19.12.2024 “*Per miratimin e kalendarit te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem 2026 - 2028 dhe buxhetit vjetor 2026 te Bashkise Shkoder*”

Veprimtaria e punës të Ekipeve të Menaxhimit të Programit (EMP), ka qene si më poshte vijon:

- Vlerësimi dhe parashikimi i të ardhurave për vitet 2026 - 2028 dhe dërgimi për miratim në Këshill Bashkiak.

- Vlerësimi i strukturese se programeve lidhur me planifikimin buxhetor per periudhen 2026 - 2028 , duke siguruar perfshirjen brenda një programi shpenzimet sipas funksioneve të bashkisë.
- Analiza e politikave dhe objektivave të programeve sipas funksioneve të veta, të deleguara dhe atyre të financuara me transfertë specifike duke marre në konsiderate të dhenat financiare të një viti me pare, vitit aktual dhe parashikimin dhe planifikimin per tre vitet e ardhshme.
- Lidhja e objektivave strategjike te percaktuara në Planin e Pergjithshëm Vendor me objektivat e Programit Buxhetor Afatmesem.
- Prioriteteve të investimeve të miratuara në PPV dhe të konsultuara me qytetarët dhe grupet e interesit, në fushën e infrastrukturës publike.
- Analizes së shpenzimeve operative (dy vite më parë, viti aktual dhe për tre vitet e ardhshme).
- Analizes se parashikimit të shpërndarjes së burimeve financiare për periudhën 2026 - 2028 , sipas çdo programi (per tre vitet e ardhshme).
- Analizës se vlerësimit të projekteve dhe lidhjen e tyre me programet e shpenzimeve publike.
- Analizes se sherbimeve të mirembajtjes se objekteve arsimore, administrative, rrugeve të brendshme dhe atyre rurale.
- Analizes se shpenzimeve të funksioneve të financuara me transfertë te pakushtezuar sektoriale, të transferuara që nga viti 2016.
- Shpërndarjen tek çdo Ekip i Menaxhimit të Programit të udhëzimeve të brendshem të nënshkruara nga titullari në lidhje me zbatimin e procedurave të programit buxhetor afatmesëm.
- Diskutimin me drejtuesit e programeve për dokumentin e risqeve të paraqitur prej tyre dhe përcaktimin e risqeve prioritare për t'u diskutuar në Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS).
- Nënshkrimin e të gjithë raporteve të përgatitjes së kerkesave buxhetore për përdorim të brendshëm të njesise në lidhje me Rishikimin e Politikës së Programit dhe Planifikimin e Shpenzimeve të Programit.
- Prezantimin tek Kryetari i Grupit të Menaxhimit Strategjik të të gjithë dokumentacionit të kerkesave buxhetore.

Bazuar ne Udhëzimin e Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë nr. 08 datë 28.02.2025 “Per pergatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026 - 2028 ” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV”; Bashkia Shkoder ka hartuar projektin e pare te programit buxhetor afatmesem 2026 – 2028 .

Në zbatim të ligjit nr.139/2015, “Për Vetqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9970, datë 24. 07. 2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, i ndryshuar, ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, i ndryshuar; si dhe të VKM nr. 334, datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”, ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Bashkia Shkodër përmes programeve sociale ofron informim, këshillim, orientim, mbrojtje e fëmijëve,

shërbime për fëmijët dhe familjen, fuqizimi ekonomik, programe prindërimi, fuqizim komunitetit, ri-integrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore të fëmijëve, ofron shërbime për familjet në vështirësi socio-ekonomike, vulnerabël ndaj fenomenit të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe gjithashtu trajton dhe mbështet viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, duke ofruar shërbime sipas nevojave specifike të secilit rast.

1.3.2 Tregues të rëndësishëm për buxhetin:

Bazuar në të dhënat për periudhën 2026–2028, më poshtë po japim një përmbledhje narrative të analizuar sipas burimeve të financimit dhe kategorive të shpenzimeve për Bashkinë Shkodër :

Analiza Financiare për vitet 2026–2028 sipas burimeve të të ardhurave dhe zërave të shpenzimeve

Të ardhurat e veta vendore për vitet 2026–2028

1. Të ardhurat e veta vendore dhe donacionet (2026–2028)

Të ardhurat e veta dhe donacionet zënë një pjesë të konsiderueshme të buxhetit vendor, duke reflektuar kapacitetin e bashkisë për të gjeneruar të ardhura të qëndrueshme nga burimet vendore. Ecuria vjetore paraqitet si vijon:

- **2026:** 1,486,257 mijë lekë
- **2027:** 1,522,361 mijë lekë (+2.4% krahasuar me 2026)
- **2028:** 1,483,213 mijë lekë (–2.6% krahasuar me 2027)

Mesatarja vjetore për periudhën **2026–2028** rezulton **1,497,277 mijë lekë**, duke reflektuar një trend të qëndrueshëm, me luhatje të moderuara përgjatë viteve.

2. Transferta e pakushtëzuar (2026–2028)

Transferta e pakushtëzuar mbetet një nga burimet kryesore të financimit të funksioneve të bashkisë. Vlerat për secilin vit janë:

- **2026:** 1,110,749 mijë lekë
- **2027:** 1,150,035 mijë lekë (+3.5% krahasuar me 2026)
- **2028:** 1,199,524 mijë lekë (+4.3% krahasuar me 2027)

Mesatarja vjetore për periudhën **2026–2028** është **1,153,436 mijë lekë**, duke shënuar një rritje progresive nga viti në vit dhe një trend pozitiv në financimin e qëndrueshëm bazë të bashkisë. Me një rritje prej **15.4%** në raport me vitin 2025

3. Transferta e pakushtëzuar sektoriale (2026–2028)

Transferta sektoriale paraqitet e pandryshuar gjatë gjithë periudhës, duke garantuar financim të qëndrueshëm për funksione specifike të deleguara:

- **2026–2028:** 639,260 mijë lekë çdo vit me nje rritje prej 13.6 % ne raport me vitin 2025.

Mesatarja për periudhën **2026–2028** është **639,260 mijë lekë**, duke reflektuar stabilitet të plotë dhe pa luhajtje strukturore në financimin sektorial.

4. Të ardhurat e trashëguara (2026–2028)

Të ardhurat e trashëguara ndikojnë vetëm në vitin 2026, ndërsa për vitet pasuese nuk rezultojnë fonde të mbartura:

- **2026:** 160,048 mijë lekë

Kategoria ka peshë vetëm në vitin 2026 dhe nuk përbën burim të vazhdueshëm të financimit për periudhën trevjeçare.

5. Totali i të ardhurave (2026–2028)

Totali i të ardhurave për periudhën 2026–2028 paraqitet si vijon:

- **2026:** 3,396,314 mijë lekë (+13.2 % krahasuar me vitin 2025)
- **2027:** 3,311,656 mijë lekë (–2.5% krahasuar me 2026)
- **2028:** 3,321,997 mijë lekë (+0.3% krahasuar me 2027)

Mesatarja vjetore për periudhën **2026–2028** është **3,343,322 mijë lekë**, duke treguar një nivel të qëndrueshëm të të ardhurave totale me variacione të kufizuara ndërvite.

Struktura e Shpenzimeve për vitet 2026–2028

• **Totali i shpenzimeve të personelit (paga dhe sigurime shoqërore)** për vitin **2026** është **1,372,601 mijë lekë**, duke zënë **40.4%** të totalit të shpenzimeve. Për vitin **2027**, janë planifikuar **1,372,562 mijë lekë** ose **41.4%** të totalit, ndërsa për vitin **2028** planifikohen **1,373,190 mijë lekë**, që përbëjnë **41.3%** të totalit të shpenzimeve.
Në terma mesatarë, shpenzimet e personelit zënë 41.0% të totalit përgjatë periudhës 2026–2028.

• **Totali i shpenzimeve operative** për vitin 2026 është **1,113,474 mijë lekë**, për vitin 2027 është **1,094,159 mijë lekë**, dhe për vitin 2028 është **1,097,535 mijë lekë**.

Këto zëra përfaqësojnë përkatësisht **32.8%**, **33%** dhe **33 %** të totalit të shpenzimeve për secilin vit.

Në mesatare, shpenzimet operative zënë 32.9% të totalit të shpenzimeve gjatë periudhës trevjeçare, duke pasqyruar kostot e funksionimit dhe shërbimeve të përditshme të bashkisë.

• **Totali i transfertave**, ku përfshihen edhe Fondi i Rezervës dhe Fondi i Kontigjencës, është **288,067 mijë lekë** në vitin 2026, **278,847 mijë lekë** në vitin 2027, dhe **280,650 mijë lekë** në vitin 2028.

Këto përbëjnë përkatësisht **8.5%**, **8.4%** dhe **8.4%** të totalit të shpenzimeve vjetore.

Mesatarisht, transfertat zënë 8.4% të shpenzimeve për periudhën 2026–2028, duke shërbyer për mbështetje financiare, ndihma sociale, si dhe për përballimin e situatave të paparashikuara.

• **Totali i shpenzimeve kapitale (investime)** për vitin 2026 është **622,172 mijë lekë**, për vitin 2027 është **566,088 mijë lekë**, dhe për vitin 2028 është **570,622 mijë lekë**.

Në përqindje ndaj totalit, këto zënë përkatësisht **18.3%**, **17.1%**, dhe **17.2%**.

Mesatarisht, investimet përbëjnë 17.5% të totalit të shpenzimeve për periudhën 2026–2028, duke reflektuar angazhimin e bashkisë për projekte zhvillimore dhe investime infrastrukturore në territorin vendor.

2. Orientimi afatgjatë i bashkisë

2.1 Strategjia e zhvillimit afatgjatë/strategjia territoriale

Burimi i informacionit: PPV/PZhS

Bazuar në direktivat kryesore të Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe Planit të Integruar Ndërsektorial të Bregdetit dhe në konsultim me palët e interesuara dhe qytetarët është hartuar objektivi afatgjatë për Bashkinë Shkodër:

“Bashkia Shkodër në 2030 do të jetë një qendër e rëndësishme kombëtare, një portë e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor dhe një nyje e rëndësishme transporti. Bashkia Shkodër është lider i rajonit ekonomik Shkodër-Lezhë-Podgoricë dhe ndërvepron me sukses si pjesë e nënrajoneve natyrore, ndërkufitare e turistike.

Një bashki me një zhvillim territorial të integruar e cila garanton barazinë në shërbime dhe në akses ndaj qytetarëve dhe vizitorëve bazuar në një sistem policentrik të zhvillimit. Një qendër primare me një cilësi të lartë jetese ku ballinat ujore dhe zonat historike gjallërojnë jetën urbane të Bashkisë Shkodër. Shkodra si një model ndërkombëtar për zhvillimin e pedalimit bazuar në kulturën qytetare të përdorimit të hapësirës së përbashkët dhe kombinimit të modaliteteve të ndryshme të transportit.

Zhvillimi Ekonomik dhe Urban ndërthuret me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, historike e natyrore. Turizmi gjithëvjeter do të jetë një vlerë e shtuar në ekonominë vendore e kombëtare duke garantuar larmshmëri në zhvillim me anë të ekoturizmit, agro-turizmit, turizmit kulturor,

malor e ujqor. Një Bashki e cila promovon dhe mbështet sipërmarrjet e reja duke tërhequr talentin vendas e rajonal.

Shkodra me një mjedis të pastër e cilësor si një bashki e aftë të përballojë presionet dhe krizat e ndryshme ekonomike, sociale e natyrore duke garantuar një cilësi të lartë jetese e zhvillimi. Shkodra bashkëjeton në harmoni me ujin dhe përballlet me sukses me rrezikun e përmbytjeve”.

Në përmbushje të këtij vizioni, janë hartuar 5 objektiva strategjike, të cilët synojnë të specifikojnë fokusin e zhvillimit të Bashkisë gjatë viteve të ardhshme. Është synuar që objektivat strategjike të jenë të prekshme, specifike dhe të monitorueshme, për të siguruar zbatueshmërinë e tyre. Për këtë arsye, janë përcaktuar edhe disa tregues monitorimi e vlerësimi për secilin objektiv strategjik, të cilët mund të detajohen dhe përmirësohen gjatë punës që Bashkia do të kryejë për zbatimin e kësaj strategjie.

Objektivi Strategjik	Programi Strategjik	Programi Buxhetor
OS1: Përmirësimi Aksesit dhe Marrëdhëniet Rajonale	OS1PS1: Terminalet multimodale	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.
	OS1PS2: Rregullimi i portave hyrëse në Shkodër	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.
	OS1PS3: Lidhjet strategjike rajonale e kombëtare	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.
	OS001PS4: Bashkëpunimi ndërkufitar	AC141 Mbështetje për zhvillimin ekonomik AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.
OS2: Integrimi Territorial dhe Barazia në Shërbime e Akses	OS2PS1: Centralitete të reja në Bashkinë Shkodër (Policentrizmi)	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.

	OS2PS2: Konsolidimi i lidhjeve të qendrave kryesore urbane	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.
	OS2PS3: Qendrat me një ndalesë dhe ngritja e kapaciteteve Lokale	AD141 Planifikim, menaxhim administrim
	OS2PS4: Qeverisja elektronike	AD141 Planifikim, menaxhim administrim
	OS2PS5: Qendrat multifunksionale dhe shërbimet sociale	AG141 Përkujdesi social
OS3: Konkurueshmëria dhe Zhvillimi Ekonomik	OS3PS1: Zhvillimi rural	Mbështetje për zhvillimin ekonomik AC141: Mbështetja për Zhvillim Ekonomik
	OS3PS2: Zhvillimi akuakulturës	
	OS3PS3: Zhvillimi turizmit	
	OS3PS4: Mbështetja e sipërmarrjeve të reja	
	OS3PS5: Zhvillimi i zonave ekonomike	
	OS3PS6: Branding i	

	Bashkisë Shkodër	
OS4: Cilësia e Lartë e Jetesës dhe Zhvillimit Urban		AB141 Siguria publike dhe mbrojtja civile
	OS4PS1: Rikualifikimi i ballinave ujore	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.
	OS4PS2: Restaurimi i ndërtesave historike dhe mbrojtja e trashëgimisë historike e kulturore	AF141 Kulturë, sport, argëtim dhe arsimi.
	OS4PS3: Rikualifikimi i hapësirave industriale dhe përdorimi i 'Broënfield'	AC141 Mbështetje për zhvillimin ekonomik AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit
	OS4PS4: Urbanizimi i zonave informale	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.
	OS4PS5: Rigjenerimi urban	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.
	OS4PS6: Përmirësimi dhe integrimi i komuniteteve rome dhe egjyptiane	AE141 Shërbimet publike vendore AG141 Përkujdesi social
	OS4PS7: Përmirësimi i qendrave të	AE141 Shërbimet publike vendore

	njësive administrative , përmes ndërhyrjeve të rikualifikimit urban	
	OS4PS8: Hapësirat publike; Hapësirat rekreative dhe sportive	AF141 Arsimi, kultura, sporti, argëtim
	OS4PS9: Përmirësimi i infrastrukturës nëntokësore të ujësjellësit dhe KUZ	AE141 Sherbimet publike vendore
	OS4PS10: Strehimi social dhe i përballueshëm	AG141 Përkujdesi Social
	OS4PS11: Eficienca energjitike dhe energjia e rinovueshme	AE141 Sherbimet publike vendore
	OS4PS12: Transporti publik	AE141 Sherbimet publike vendore
	OS4PS13: Biçikletat	AE141 Sherbimet publike vendore
	OS4PS14: Gjallëria urbane	AF141 Arsimi, kultura, sporti, argëtim AC141 Mbështetje për zhvillimin ekonomik
	OS4PS15: Parkimet	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.

OS5: Mbrojtja e mjedisit dhe aftësia për tu përshtatur, mbrojtur dhe rimëkëmbur nga rreziqet natyrore	OS5PS1: Mbrojtja e mjedisit	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.
	OS5PS2: Mbrojtja nga përmbytjet	AB141 Siguria publike dhe mbrojtja civile
	OS5PS3: Përmirësimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane	AE141 Shërbimet publike vendore
	OS5PS4: Mbrojtja e akuifereve nga ndotja	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit
	OS5PS5: Qendra e menaxhimit nga risku i përmbytjeve	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.
	OS5PS6: Menaxhimi i rreziqeve natyrore	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.
	OS5PS7: Menaxhim i pyjeve dhe kullotave	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit. http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/04260_3515.pdf
	OS5 PS8: Ndryshimet klimatike	AD141 Planifikimi, kontrolli i territorit dhe mjedisit.

2.2 Sfidat kryesore të zhvillimit

Burimi i informacionit: PPV/PZhS; të tjera

Bashkia Shkodër ka identifikuar një sërë prioritetesh strategjike për zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të territorit. Një nga fokusat kryesore është përmirësimi i lidhjeve të transportit, duke përfshirë rrugët, hekurudhat dhe transportin ujor. Këto investime synojnë të lehtësojnë qarkullimin brenda dhe jashtë bashkisë, duke stimuluar aktivitete ekonomike dhe integrimin rajonal.

Në të njëjtën kohë, përmes përmirësimit të infrastrukturës rurale, synohet zvogëlimi i pabarazive dhe sigurimi i aksesit të barabartë ndaj shërbimeve administrative për të gjithë qytetarët, duke krijuar kushte më të favorshme për zhvillimin e komuniteteve rurale.

Një tjetër fokus është zhvillimi i ish-zonave industriale, duke i përshtatur ato për lidhje më të mira me akse kryesore ekonomike dhe duke kontribuar në forcimin e Shkodrës si një qendër rajonale ekonomike. Ky proces lidhet ngushtë me rigjenerimin urban të lagjeve, ku rikualifikimi i hapësirave publike synon kthimin e tyre në ambjente funksionale dhe të këndshme për qytetarët.

Në aspektin mjedisor, prioritet është menaxhimi i mbetjeve dhe riciklimi, për të reduktuar ndikimin negativ në qytete dhe zona rurale, si dhe mbrojtja e biodiversitetit, duke ruajtur ekosistemet e liqeneve dhe lumenjve dhe duke reduktuar ndotjen. Këto hapa lidhen me një vizion më të gjerë për zhvillimin e ekonomisë së gjelbër dhe blu, ku integrimi i sektorëve të qëndrueshëm ekonomikë është i lidhur ngushtë me mbrojtjen e mjedisit.

Bashkia gjithashtu synon zhvillimin e sektorëve të ndryshëm ekonomikë, duke përfshirë zhvillimin rural, turizmin, industrinë e lehtë, shërbimet dhe ekonominë digjitale, duke përfshirë ekonominë blu dhe të gjelbër. Një komponent i rëndësishëm është përfshirja e brezave të rinj, duke krijuar mundësi për pjesëmarrje aktive në ekonominë lokale dhe iniciativat e reja.

Investimet në kapacitetet e teknologjisë së informacionit dhe integrimi i turizmit me sektorë të tjerë ekonomikë synojnë të krijojnë sinergji dhe mundësi të reja zhvillimi, duke lidhur sektorët bujqësor, industrial dhe shërbimet me zhvillimin turistik dhe teknologjik.

Sa mësipër, strategjia e Bashkisë Shkodër kombinon përmirësimin e infrastrukturës, zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, mbrojtjen e mjedisit dhe integrimin e rinisë, duke synuar një zhvillim gjithëpërfshirës dhe harmonizim të aktiviteteve urbane dhe rurale.

2.3 Plani i shpenzimeve kapitale 2026 - 2028 ne 000/leke

	Raporti: PBA8 - Projektet e Investimeve NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër PBA: 2026 - 2028				
KODI	EMËRTIMI I PROJEKTIT/PRODUKTIT	BURIMI I FINANCIMIT	2026 PLANI	2027 PLANI	2028 PLANI
Shpenzimet Kapitale sipas Projekteve					
P426AAG	Hartim plani i Menaxhimit të Pyjeve e Kullotave të Bashkisë Shkoder (1410825)	Financim i Brendshëm	2,251	4,000	4,000
P626ACB	Rikonstruksion rrugë Shkodër Qendër	Financim i Brendshëm	0	266,206	278,645
P626ACC	Rikualifikim Urban Bllqe banimi Shkoder Qender (P626ACC)	Financim i Brendshëm	0	60,134	60,134
P452ADB	Rehabilitim, shtrim dhe asfaltim i rrugeve ne Njesi Administrative (1410913)	Financim i Brendshëm	0	90,461	90,461
P813- SH-012	Ndertim i ambjenteve sportive te gjimnazit 28 Nentori	Financim i Brendshëm	1,676	0	0
P813- SH-014	Ndertim i ambjenteve sportive te ShkollesTring Smajli	Financim i Brendshëm	5,338	0	0

P066AAM	Ndërtim i banesave për strehim social blerje banesa ne treg te lire/ pershtatje e objekteve te dala jashte funksioni per strehim etj.	Financim i Brendshëm	60,000	60,000	60,000
P923AAO	Rikonstrukcion shkolla te mesme te pergjithshme (P923AAO)	Financim i Brendshëm	0	5,000	15,991
P912ABO	Projekte Rikonstrukcion i shkollave dhe fusha sporti (1410948)	Financim i Brendshëm	11,800	0	0
P912- SH-014	Rikonstrukcion I godinave shkollore	Financim i Brendshëm	0	0	10,000
P912ACD	Rikonstrukcion Kopshti Ton Alimhilli (P912ACD)	Financim i Brendshëm	4,600	0	0
P912ACE	Rikonstrukcion dhe ndërtim palestre Shkolla e hapur Ismail Qemali (P912ACE)	Financim i Brendshëm	29,981	0	0
P426- SH-002	Projekti Building Smart Forests	Financim i Brendshëm	2,591	0	0
P422- SH-002	Rikonstrukcion streheza e re e qenve. Faza II	Financim i Brendshëm	7,664	0	0
P510AAU	REUSEFUL– Promovimi i reduktimit të mbetjeve përmes qendrave të ripërdorimit në zonën e Adriatikut të Jugut (P510AAU)	Financim i Huaj	1,810	24,997	179
P626- SH-018	Ndërtimi I tualeteve publike	Financim i Brendshëm	19,074	0	0
P413- SH-003	Projekti Arti per Europen (ARTE)	Financim i Huaj	130	650	0
P452- SH-016	Rikonstrukcion i urave ne fshatin turistik Theth	Financim i Brendshëm	12,000	0	0
P626- SH-019	Rikonstrukcion Blloku Rruga Çakej (Faza 1)	Financim i Brendshëm	23,685	0	0
P626- SH-020	Rikonstrukcion Rruga Leke Dukagjini (Faza 1)	Financim i Brendshëm	29,800	0	0
P626- SH-021	Rikonstrukcion Rruga Komanej	Financim i Brendshëm	22,000	0	0
P626- SH-022	Rikonstrukcion Rruga Luigj Benusi	Financim i Brendshëm	20,000	0	0
P626- SH-023	Rikonstrukcion Blloqet e pallateve në Rr. Koplikej, Rr. Kupe Danja, Rr. Zija Shkodra, Rr. Bahçja e Sokoleve (Faza I)	Financim i Brendshëm	30,600	0	0
P626- SH-026	Rikonstrukcion Rruga Dora D'Istria	Financim i Brendshëm	10,000	0	0
P626- SH-027	Rikonstrukcion Degezim Rruga Tepe (Qafehardhi)	Financim i Brendshëm	3,000	0	0
P626- SH-024	Rikonstrukcion Rruga Edit'h Durham	Financim i Brendshëm	6,500	0	0
P626- SH-025	Rikonstrukcion Rruga Frang Bardhi	Financim i Brendshëm	14,000	0	0

P452- SH-017	Rikonstruksion Rruga Dodaj-Shtuf	Financim i Brendshëm	11,000	0	0
P452- SH-022	Rikonstruksion Rruga e Varrezave në fshatin Rrushkull	Financim i Brendshëm	10,000	0	0
P452- SH-023	Rikonstruksion Rruga Isa Jakupi, Dobrac (Faza I)	Financim i Brendshëm	25,000	0	0
P452- SH-024	Rikonstruksion Rruga Muhaj	Financim i Brendshëm	8,000	0	0
P452- SH-018	Rikonstruksion Rruga e Mullomanit	Financim i Brendshëm	6,000	0	0
P452- SH-019	Rikonstruksion Rruga Fshati i Ri (Faza I)	Financim i Brendshëm	14,000	0	0
P452- SH-020	Rikonstruksion Trotuari Guri I Zi	Financim i Brendshëm	12,000	0	0
P452- SH-021	Rikonstruksion Rruga Prekaj dhe Luiz Ndoci (Faza I)	Financim i Brendshëm	14,500	0	0
P091AAH	Projekti Territory (P091AAH)	Financim i Huaj	634	3,635	0
P813- SH-016	Rikonstruksion total i Pallatit të Sportit 'Qazim Dervishi'	Financim i Brendshëm	60,016	0	0
P813- SH-017	Projektim Rikonstruksione fusha sportive	Financim i Brendshëm	10,000	0	0
P912- SH-021	Shtese dhe sistem kapote Shkolla Shtoj i Ri	Financim i Brendshëm	1,103	0	0
P912- SH-022	Shtese dhe sistem kapote Shkolla Xheladin Fishta	Financim i Brendshëm	1,976	0	0
P043- SH-004	Rikonstruksion Cerdhe Perash	Financim i Brendshëm	1,640	0	0
Totali i Shpenzimeve Kapitale			494,369	515,083	519,410
sipas Projekteve					
Shpenzimet Kapitale sipas Produkteve					
V111AAB	Akte te Miratuara nga Këshilli Bashkiak		90	90	90
V111AAD	Mirëmbajtja e Infrastrukturës dhe Funksionimi I Aparatit të Bashkisë		2,959	2,959	2,959
V112AAB	Subjekte Tregtare të Inspektuara		144	144	144
V314AAB	Patrullim për Sigurinë Publike		13,800	0	0
V328AAC	Raste të Menaxhuara të Zjarrit dhe Shpëtimit		4,000	1,000	1,000
V091AAB	Ndërhyrje Parandaluese dhe Emergjente		7,800	0	0
V476AAA	Shërbimi i Stafit të Zhvillimit të Turizmit		500	500	500
V614AAC	Projekte të Zhvillimit Urban të Hartuara dhe Monitoruara		19,000	19,000	19,000
V457AAA	Shërbimi i Transportit Publik		5,000	5,000	5,000
V510AAB	Mbledhje dhe Transportim i Mbetjeve nga Zonat Urbane		6,849	6,849	6,849

V644AAB	Rrjeti i Ndriçimit Rrugor Publik Urban i Mirëmbajtur		9,000	0	0
V813AAB	Disiplinat e Ndryshme Sportive të Mbështetura		21,500	0	0
V822AAC	Objekte të Trashëgimisë Kulturore të Mirëmbajtura		1,492	1,492	1,700
V822AAK	Funksionimi i Bibliotekës		1,200	1,500	1,500
V823AAB	Objekte të veprimtarisë kulturore dhe artistike të mirëmbajtura dhe funksionale		4,265	765	765
V912AAB	Objekte të Arsimit Baze dhe Parashkollor të Mirëmbajtura dhe Funksionale		19,200	5,700	5,700
V912AAD	Fëmijë që Ndjekin Kopështin		4,000	4,000	4,000
V923AAB	Objekte të Arsimit të Mesëm të Mirëmbajtura dhe Funksionale		6,605	1,605	1,605
V043AAC	Fëmijë që Frekuentojnë Çerdhet		400	400	400
Totali i Shpenzimeve Kapitale			127,804	51,004	51,212
sipas Produkteve					
Totali i Përgjithshëm			622,173	566,087	570,622

3. Informacion financiar

3.1 Burimi i te ardhurave


Buxheti total i Bashkisë Shkodër me burim financimi transfertën e pakushtezuar, transfertën sektoriale dhe te ardhurat e veta përfshirë dhe donacionet për vitin 2026 është 2,882,385 mijë lekë, në vitin 2027 është planifikuar 2 914 790 mijë lekë, ndërsa në vitin 2028 është planifikuar 2 976 520 mijë lekë.

Financimi i buxhetit realizohet nga:

- **Nga burimet e veta vendore**, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat vendore, të ardhurat tjera dhe të ardhurat që trashëgohen.
- **Nga grantet e projekteve të huaja dhe donacionet**, ku përfshihen grantet e përfituara përmes thirrjeve për propozime, për zbatimin e projekteve të financuara nga programet e Bashkëpunimit Ndërkufitar etj, në përputhje me ligjet për ratifikimin e marrëveshjeve të financimit dhe VKM-ve për miratim në parim të marrëveshjeve të financimit.
- **Nga burimet qendrore**, ku përfshihen transfertat e pakushtezuar, transfertat e pakushtezuar sektoriale për funksionet e reja, që i janë transferuar Bashkisë, dhe transfertat specifike për menaxhimin e mbetjeve.

			000/leke
	VITI 2026	VITI 2027	VITI 2028
ARDHURAT E VETA & DONACIONE	1,486,257	1,522,361	1,483,213
TRANSFERTA E PAKUSHTEZUAR	1,110,749	1,150,035	1,199,524
TRANSFERTA PAKUSHTEZUAR SEKTORIALE	639,260	639,260	639,260
TE TRASHEGUARA	160,048	-	-
TOTALI	3,396,314	3,311,656	3,321,997

Tabela 1 Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë Shkodër




Grafik 1 Burimet e Financimit të PBA 2026 - 2028

Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Shkodër për vitet 2026 - 2028

Të ardhurat nga burimet qendrore, rezultojnë të jenë element dominues dhe përcaktues në strukturën dhe performancën e të ardhurave totale. Varësia financiare nga transfertat ndërqeveritare bën që planifikimi i investimeve kapitale të jetë subjekt i kushtëzuar pothuajse tërësisht nga vendimet e qeverisë qendrore.

Pavarësia financiare e Bashkisë Shkodër, matur si raport i të ardhurave të veta vendore ndaj të ardhurave totale, rezulton mesatarisht 46.4 % për trevjeçarin 2026 - 2028 . Niveli i të ardhurave vendore përcaktohet në masën më madhe nga performanca e taksave dhe tarifave vendore.

Grafik 2 Raporti i burimeve të financimit 2026 - 2028



Të ardhurat nga burimet e veta

Të ardhurat nga burimet e veta përbëjnë komponentin kryesor të autonomisë financiare të bashkisë. Për vitin 2026, ato janë parashikuar në **1,344,391 mijë lekë**, ndërsa për vitin 2027 projektohen **1,353,724 mijë lekë**, duke shënuar një rritje të lehtë prej **+0.7%** krahasuar me vitin 2026. Në vitin 2028, parashikohet një ulje e lehtë në **1,344,802 mijë lekë**, ose **-0.7%** krahasuar me vitin 2027.

Transfertat nga qeveria qendrore mbeten burimi më i rëndësishëm i financimit të bashkisë, duke siguruar mbështetje për funksionet e detyruara dhe për garantimin e shërbimeve publike.

Për vitin 2026, totali i transfertave arrin **1,750,009 mijë lekë**. Ky trend rritës vijon edhe në vitin 2027 me **1,789,295 mijë lekë** (+2.2%), për të arritur në **1,838,784 mijë lekë** në vitin 2028 (+2.8% krahasuar me 2027). Kjo ecure tregon një politikë të qëndrueshme transferimi nga qeveria qendrore në mbështetje të buxhetit vendor.

Transferta e Pakushtëzuar e Përgjithshme

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme – burimi kryesor për mbulimin e funksioneve administrative dhe shërbimeve të përgjithshme – arrin në **1,110,749 mijë lekë** në vitin 2026. Ajo rritet në **1,150,035 mijë lekë** në vitin 2027 (+3.5%) dhe në **1,199,524 mijë lekë** në vitin 2028 (+4.3%).

Rritja e qëndrueshme e kësaj kategorie garanton funksionimin bazë të bashkisë dhe mundëson planifikim financiar më afatgjatë.

Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale

Kjo kategori mbetet **e pandryshuar** përgjatë periudhës 2026–2028, në vlerën **639,260 mijë lekë** për çdo vit. Stabiliteti i saj pasqyron politikat qendrore të financimit të funksioneve të deleguara, kryesisht në arsim, shëndetësi dhe shërbime të tjera specifike.

Të ardhurat nga taksat e ndara

Taksat e ndara paraqesin një burim të qëndrueshëm financimi për bashkinë, me ndikim të drejtpërdrejtë nga aktiviteti ekonomik dhe lëvizja e mjeteve dhe individëve në territor.

Gjatë vitit 2026, totali i të ardhurave nga taksat e ndara arrin në **136,035 mijë lekë**. Në vitin 2027 kjo kategori rritet lehtë në **137,535 mijë lekë** (+1.1%) dhe mbetet **e pandryshuar** në vitin 2028 (**137,535 mijë lekë**).

Ecuria tregon stabilitet fiskal dhe parashikueshmëri të mirë për këtë kategori të ardhurash.

Grantet dhe transfertat e tjera

Grantet dhe transfertat e tjera, megjithëse përbëjnë një peshë të vogël në total, kanë rol të rëndësishëm në financimin projektor dhe ndërhyrjet specifike.

Në vitin 2026, ato arrijnë **5,831 mijë lekë**, ndërsa në vitin 2027 parashikohen **31,102 mijë lekë**, për shkak të projekteve të financuara nga donatorët. Në vitin 2028, ky zë kthehet në nivel shumë të ulët prej vetëm **876 mijë lekë**, duke treguar mbylljen e projekteve shumëvjeçare të financuara nga grantet e huaja.

Trashëgimi nga viti i kaluar

Në vitin 2026, parashikohet një mbetje e pashpenzuar nga viti 2025 në vlerën **160,048 mijë lekë**, e cila përdoret për të balancuar buxhetin. Për vitet 2027 dhe 2028, trashëgimia nuk parashikohet (0 lekë).

Përmbledhje e përgjithshme

Totali i burimeve të financimit të Bashkisë Shkodër për periudhën 2026–2028 është si vijon:

- **Viti 2026: 3,396,314 mijë lekë**
- **Viti 2027: 3,311,656 mijë lekë**
- **Viti 2028: 3,321,997 mijë lekë**

Struktura e të ardhurave tregon:

- **Stabilitet të transfertave nga buxheti qendror**, me rritje të lehtë vjetore.
- **Qëndrueshmëri të të ardhurave nga burimet e veta**, pavarësisht efektit të jashtëzakonshëm të vitit 2025 për shkak të mbledhjes së detyrimeve të prapambetura.
- **Taksat e ndara mbeten konstante**, duke ofruar një burim të sigurt dhe të parashikueshëm.
- **Grantet** variojnë sipas projekteve specifike, pa ndikim të ndjeshëm në total.

Në përgjithësi, Bashkia Shkodër ruan një politikë të ekuilibruar fiskale dhe një trend të qëndrueshëm rritjeje të të ardhurave, duke mundur planifikim funksional dhe investime të qëndrueshme për periudhën afatmesme 2026–2028

Tabela 2 Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit të financimit

Raporti: PBA2 - Parashikimi i të Ardhurave

NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	Burimet Buxhetore	2023 Fakti	2024 Fakti	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2026 Plani	2027 Plani	2028 Plani
1	TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	701,774	855,217	1,125,924	1,125,924	1,344,391	1,353,724	1,344,802
1.1	TAKSA E PASURISË SË PALUAJTSHME	205,978	206,122	267,668	267,668	263,450	264,551	264,336
1.1.1	Taksa mbi Ndërtesën	171,488	171,114	201,932	201,932	198,714	199,714	200,000
1.1.2	Taksa mbi tokën bujqësore	8,226	6,785	22,986	22,986	22,299	22,299	21,736
1.1.3	Taksa mbi truallin	15,614	18,644	23,750	23,750	23,437	23,538	23,600
1.1.4	Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme	10,650	9,579	19,000	19,000	19,000	19,000	19,000
1.2	TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA	65,703	176,295	297,000	297,000	547,000	548,000	549,000
1.2.1	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	65,703	176,295	297,000	297,000	547,000	548,000	549,000
1.3	TAKSA TË TJERA VENDORE	42,620	52,912	47,000	47,000	49,500	50,600	51,700

1.3.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	1,898	2,558	1,000	1,000	500	500	500
1.3.2	Taksa vendore në shërbimin hotelier	26,609	33,960	30,000	30,000	33,000	34,000	35,000
1.3.3	Taksa e tabelës	14,113	16,394	16,000	16,000	16,000	16,100	16,200
1.4	TARIFA VENDORE	358,162	374,072	457,712	457,712	440,302	445,324	434,517
1.4.1	Tarifa e menaxhimit të mbetjeve	184,424	180,171	220,320	220,320	206,645	206,845	206,914
1.4.2	Tarifa për zënien e hapësirës publike	0	66,721	0	65,000	53,000	53,100	53,200
1.4.3	Tarifa për ndriçimin publik	47,610	50,148	69,478	69,478	65,278	65,478	65,526
1.4.4	Tarifa për gjelbërimin	25,589	26,789	30,410	30,410	28,960	29,160	29,310
1.4.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	79,383	26,003	104,213	28,213	21,368	25,250	13,476
1.4.6	Tarifa të institucioneve të arsimit	15,859	17,081	22,351	22,351	22,301	22,301	22,301
1.4.7	Tarifa të institucioneve të kulturës dhe sportit	5,297	7,159	6,930	6,930	15,350	15,290	15,390
1.4.8	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	0	0	0	0	0	0	0
1.4.9	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	0	0	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000
1.4.10	Tarifa e përkohëshme	0	0	0	0	0	0	0
1.4.11	Tarifa e parkimit	0	0	0	11,000	21,000	21,500	22,000
1.4.12	Tarifa të tjera	0	0	10	10	2,400	2,400	2,400
1.5	TË ARDHURA NGA ASETET DHE AKTIVITETI EKONOMIK	6,131	3,776	5,044	5,044	5,139	6,249	6,249
1.5.1	Të ardhura nga ndërmarrjet publike	0	0	0	0	0	0	0

1.5.2	Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë	3,302	3,714	2,874	2,874	2,967	4,077	4,077
1.5.3	Të ardhura nga partneriteti publik privat	0	0	0	0	0	0	0
1.5.4	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	0	0	1,800	1,800	1,800	1,800	1,800
1.5.5	Shitja e aseteve financiare	0	0	0	0	0	0	0
1.5.6	Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	0	0	0	0	0	0	0
1.5.7	Të tjera	2,829	62	370	370	372	372	372
1.6	TË TJERA ADMINISTRATIVE	23,180	42,040	51,500	51,500	39,000	39,000	39,000
1.6.1	Kamatëvonesat	0	0	0	0	0	0	0
1.6.2	Gjoha, sekuestime dhe zhvendëtime	23,180	42,040	51,500	51,500	39,000	39,000	39,000
1.6.3	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0
2	TRANSFERTA NGA BUXHETI QËNDROR	1,337,372	1,454,161	1,601,937	1,607,052	1,750,009	1,789,294	1,838,784
2.1	TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME	879,972	957,789	1,039,175	1,039,175	1,110,749	1,150,035	1,199,524
2.1.1	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	879,972	936,996	938,456	938,456	982,156	1,021,441	1,070,931
2.1.2	Rritja e nivelit të pagave	0	20,793	100,719	100,719	128,593	128,593	128,593
2.1.3	Fond shtesë nga Kuvendi	0	0	0	0	0	0	0
2.2	TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE	457,400	496,372	562,762	567,877	639,260	639,260	639,260

2.2.1	Konviktet e arsimit parauniversitar	60,260	47,879	63,930	63,930	65,848	65,848	65,848
2.2.2	Arsimi parashkollor - Për Personelin Arsimor	143,833	183,130	199,468	199,468	214,222	214,222	214,222
2.2.3	Arsimi parashkollor - Për stafin mbështetës	61,255	47,302	67,533	67,533	86,542	86,542	86,542
2.2.4	Arsimi parauniversitar	29,079	44,848	31,884	31,884	39,740	39,740	39,740
2.2.5	Mbrojtja nga zjarri	45,058	50,121	67,343	72,458	72,901	72,901	72,901
2.2.6	Mbrojtja sociale	37,233	38,183	44,503	44,503	66,890	66,890	66,890
2.2.7	Administrimi i pyjeve	12,958	13,543	14,084	14,084	16,761	16,761	16,761
2.2.8	Rrugët	20,697	23,061	23,784	23,784	24,505	24,505	24,505
2.2.9	Ujitja dhe Kullimi	31,027	31,980	33,257	33,257	36,552	36,552	36,552
2.2.10	Klubet shumësportëshe "Partizani" dhe "Studenti"	0	0	0	0	0	0	0
2.2.11	Menaxhimi i mbetjeve urbane	16,000	16,325	16,977	16,977	15,300	15,300	15,300
2.2.12	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0
2.3	TRANSFERTA TË KUSHTËZUARA	0	0	0	0	0	0	0
2.3.1	Për funksione të deleguara	0	0	0	0	0	0	0
2.3.2	Për projekte të veçanta	0	0	0	0	0	0	0
2.4	TRANSFERTË SPECIFIKE	0	0	0	0	0	0	0
2.4.1	Transfertë specifike	0	0	0	0	0	0	0
3	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	156,227	166,796	136,035	136,035	136,035	137,535	137,535

3.1	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	101,350	105,131	91,000	91,000	91,000	91,500	91,500
3.2	Renta minerare	1	310	35	35	35	35	35
3.3	Tatimi mbi të ardhurat personale	54,876	61,355	45,000	45,000	45,000	46,000	46,000
3.4	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0
4	GRANTE DHE TRANSFERTA TË TJERA	83,028	2,127	620	1,906	5,831	31,102	875
4.1	TRANSFERTA NGA I NJËJTI NIVEL QEVERISJE	29,156	0	0	0	0	0	0
4.1.1	Transferta nga i njëjti nivel qeverisje	29,156	0	0	0	0	0	0
4.2	GRANTE TË TJERA TË BRENDSHME	0	0	0	0	0	0	0
4.2.1	Grante të Tjera të Brendshme	0	0	0	0	0	0	0
4.3	GRANTE TË HUAJA	53,872	2,127	620	1,906	5,831	31,102	875
4.3.1	Grante të huaja	53,872	2,127	620	1,906	5,831	31,102	875
5	HUAMARRJA	0	0	0	0	0	0	0
5.1	Huamarrja afatshkurtër	0	0	0	0	0	0	0
5.2	Huamarrja afatgjatë	0	0	0	0	0	0	0
6	TRASHËGIMI NGA VITI I KALUAR	967,950	1,237,201	70,385	1,651,612	160,048	0	0
6.1	Trashëgimi pa destinacion	873,312	1,060,439	70,385	1,581,227	0	0	0
6.2	Trashëgimi me destinacion	94,638	176,762	0	70,385	160,048	0	0

TOTALI I TË ARDHURAVE TË NJVQV	3,246,351	3,715,502	2,934,901	4,522,529	3,396,314	3,311,656	3,321,996
---	------------------	------------------	------------------	------------------	------------------	------------------	------------------

Grafik 3 Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit (në % ndaj totalit)



3.1.1 Të ardhurat e veta të bashkisë.

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, të ardhura nga taksat e ndara, nga tarifat vendore, dhe të ardhurat e tjera

Llogaritja e të ardhurave mbështetet në:

1. *Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", te ndryshuar;*
2. *Ligjin nr.9920 datë 26.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar;*
3. *Vendimin e Këshillit të Bashkisë Shkodër nr 1 date 22.01.2016 "Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Shkodër", të ndryshuar;*
4. *Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".*

Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifatat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Shkodër, të përditësuar, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, detajon çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administrimit, përcakton qartë edhe administrimin e saj duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj.

Në përditësimin e paketës fiskale të Bashkisë së Shkodrës ndër vite, janë përfshirë përfaqësues të biznesit të madh dhe të vogël, banorë të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit dhe përfaqësues të partive politike e këshilltarë.

Diskutimet publike janë organizuar në çdo njësi administrative dhe në qytet. Për ndryshimet dhe përditësimet e paketës fiskale janë bërë takime konsultative gjithpërfshirëse. Gjatë këtyre takimeve bashkëqytetarë, banorë, përfaqësues të grupeve të interesit, është diskutuar dhe janë bërë propozime për përmirësim.

Paketa fiskale e Bashkisë Shkodër, pasqyron disa politika të rëndësishme për uljen e disa niveleve ligjore/kufi, etj.sipas kompetencave ligjore, si më poshtë:

- ✓ Politikat incentivuese në taksa:
 - *Ulje e taksës së ndërtesës për qëllime banimi në Nj.A. në 30% nga referenca ligjore.*
 - *Taksë banese zero për pensionistët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike.*
 - *Ulje e taksës së ndërtesës për qëllime biznesi në Nj.A. në 30% nga referenca ligjore.*
 - *Ulje në nivelin maksimal të lejuar prej 30% të taksës së tokës bujqësore.*
- ✓ Politikat incentivuese dhe uljet nën nivelet e kostos së shërbimit të llogaritur:
 - *Tarifa zero për shërbimin e gjelbërimit për zonat rurale*
 - *Tarifa minimale deri në zero për shërbimin e ndriçimit publik në zonat rurale*


- *Tarifa zero për familjet me ndihmë ekonomike.*
- *Tarifa të reduktuara 50% sipas kriterëve për pensionistë, invalidë, etj.*
- *Tarifa 0 (zero) për fermerët që janë regjistruar me NIPT nga Drejtoria Tatimore*
- *Tarifa të ulëta pastrimi, dhe pa tarifa të tjera për ambulantët*

Bashkia Shkodër, tashmë, ka ndërtuar një sistem të integruar me një ndalesë për regjistrimin dhe shërbimin për taksa pagesit biznes dhe familje të shpërndarë në të gjithë territorin e Bashkisë. Janë ndërtuar bazat e të dhënave gjithnjë e më të sakta të taksapaguesve, sipas kategorive, biznes dhe familje, dhe nga viti në vit janë konsoliduar dhe siguruar të dhëna gjithnjë e më të sakta për bazën e taksueshme dhe nivelin e aplikueshëm të tarifave sipas llojit. Sipas ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 35/2, bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimit e tyre brenda kufijve e sipas kriterëve të përcaktuara me ligj.

Tabela 3 Të ardhurat e veta

Burimet Buxhetore	2023 Fakti	2024 Fakti	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2026 Plani	2027 Plani	2028 Plani
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	701,774	855,217	1,125,924	1,125,914	1,344,391	1,353,724	1,344,802
TAKSA E PASURISË SË PALUAJTSHME	205,978	206,122	267,668	267,668	263,450	264,551	264,336
TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA	65,703	176,295	297,000	297,000	547,000	548,000	549,000
TAKSA TË TJERA VENDORE	42,620	52,912	47,000	47,000	49,500	50,600	51,700
TARIFA VENDORE	358,162	374,072	457,712	457,702	440,302	445,324	434,517
TË ARDHURA NGA ASETET DHE AKTIVITETI EKONOMIK	6,131	3,776	5,044	5,044	5,139	6,249	6,249
TË TJERA ADMINISTRATIVE	23,180	42,040	51,500	51,500	39,000	39,000	39,000
TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	156,227	166,796	136,035	136,035	136,035	137,535	137,535
GRANTE DHE TRANSFERTA TË TJERA	83,028	2,127	620	1,906.2	5,830.8	31,102.3	875.3


Pesha e të ardhurave të veta sipas klasifikimit ekonomik 2026-2028



Grafik 4 Pesha e të ardhurave të veta sipas klasifikimit ekonomik 2026-2028

Të ardhurat e veta, që mbledhen nga administrata e Bashkisë në vitet 2026-2028 parashikohen që të kenë një trend mesatarisht të njëtrajtshëm për tre vitet e ardhshme.

Kategoritë e taksave dhe tarifave që ndikojnë më shumë në planin e të ardhurave nga burimet e veta për vitet 2026-2028 janë kryesisht taksa e pasurisë së paluajtshme që zë rreth 20%, taksa e ndikimit në infrastrukturë që zë rreth 41%, tarifa vendore zë rreth 33%, taksa të tjera vendore me 4%, taksa të tjera administrative me 3% etj.



Grafik 5 Pesha e çdo taksë dhe tarifë në parashikimin e të ardhurave

Planifikimi i të ardhurave të veta për vitet 2026-2028 i kategorizuar sipas klasifikimit ekonomik ligjor paraqitet si më poshtë:

Tabela 4 Të ardhurat e veta për vitet 2026-2028 sipas klasifikimit ekonomik

	Burimet Buxhetore	2023 Fakti	2024 Fakti	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2026 Plani	2027 Plani	2028 Plani
1	TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	701,774	855,217	1,125,924	1,125,924	1,344,391	1,353,724	1,344,802
1.1	TAKSA E PASURISË SË PALUAJTSHME	205,978	206,122	267,668	267,668	263,450	264,551	264,336
1.1.1	Taksa mbi Ndërtesën	171,488	171,114	201,932	201,932	198,714	199,714	200,000
1.1.2	Taksa mbi tokën bujqësore	8,226	6,785	22,986	22,986	22,299	22,299	21,736
1.1.3	Taksa mbi truallin	15,614	18,644	23,750	23,750	23,437	23,538	23,600
1.1.4	Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme	10,650	9,579	19,000	19,000	19,000	19,000	19,000
1.2	TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA	65,703	176,295	297,000	297,000	547,000	548,000	549,000
1.2.1	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	65,703	176,295	297,000	297,000	547,000	548,000	549,000
1.3	TAKSA TË TJERA VENDORE	42,620	52,912	47,000	47,000	49,500	50,600	51,700
1.3.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	1,898	2,558	1,000	1,000	500	500	500
1.3.2	Taksa vendore në shërbimin hotelier	26,609	33,960	30,000	30,000	33,000	34,000	35,000
1.3.3	Taksa e tabelës	14,113	16,394	16,000	16,000	16,000	16,100	16,200
1.3.4	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testamen...	0	0	0	0	0	0	0
1.3.5	Taksa e përkohëshme	0	0	0	0	0	0	0
1.4	TARIFA VENDORE	358,162	374,072	457,712	457,712	440,302	445,324	434,517
1.4.1	Tarifa e menaxhimit të mbetjeve	184,424	180,171	220,320	220,320	206,645	206,845	206,914
1.4.2	Tarifa për zënien e hapësirës publike	57,061	66,721	65,000	65,000	53,000	53,100	53,200
1.4.3	Tarifa për ndriçimin publik	47,610	50,148	69,478	69,478	65,278	65,478	65,526
1.4.4	Tarifa për gjelbërimin	25,589	26,789	30,410	30,410	28,960	29,160	29,310
1.4.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	14,544	14,696	28,213	28,213	21,368	25,250	13,476
1.4.6	Tarifa të institucioneve të arsimit	15,859	17,081	22,351	22,351	22,301	22,301	22,301
1.4.7	Tarifa të institucioneve të kulturës dhe sportit	5,297	7,159	6,930	6,930	15,350	15,290	15,390
1.4.8	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	0	0	0	0	-	0	0

1.4.9	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	0	0	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000
1.4.10	Tarifa e përkohëshme	0	0	0	0	-	0	0
1.4.11	Tarifa e parkimit	7778	11307	11000	11000	21,000	21,500	22,000
1.4.12	Tarifa të tjera	0	0	10	10	2400	2400	2400
1.5	TË ARDHURA NGA ASETET DHE AKTIVITETI EKONOMIK	6,131	3,776	5,044	5,044	5,139	6,249	6,249
1.5.1	Të ardhura nga ndërmarrjet publike	0	0	0	0	0	0	0
1.5.2	Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë	3,302	3,714	2,874	2,874	2,967	4,077	4,077
1.5.3	Të ardhura nga partneriteti publik privat	0	0	0	0	0	0	0
1.5.4	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	0	0	1,800	1,800	1,800	1,800	1,800
1.5.5	Shitja e aseteve financiare	0	0	0	0	0	0	0
1.5.6	Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	0	0	0	0	0	0	0
1.5.7	Të tjera	2,829	62	370	370	372	372	372
1.6	TË TJERA ADMINISTRATIVE	23,180	42,040	51,500	51,500	39,000	39,000	39,000
1.6.1	Kamatëvonesat	0	0	0	0	0	0	0
1.6.2	Gjoha, sekuestrime dhe zhdëmtime	23,180	42,040	51,500	51,500	39,000	39,000	39,000
1.6.3	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0
3	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	156,227	166,796	136,035	136,035	136,035	137,535	137,535
3.1	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	101,350	105,131	91,000	91,000	91,000	91,500	91,500
3.2	Renta minerare	1	310	35	35	35	35	35
3.3	Tatimi mbi të ardhurat personale	54,876	61,355	45,000	45,000	45,000	46,000	46,000
3.4	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0
4	GRANTE DHE TRANSFERTA TË TJERA	83,028	2,127	620	1,906.2	5,830.8	31,102.3	875.3
4.1	TRANSFERTA NGA I NJËJTI NIVEL QEVERISJE	29,156	0	0	0	0	0	0
4.1.1	Transferta nga i njëjti nivel qeverisje	29,156	0	0	0			0
4.2	GRANTE TË TJERA TË BRENDSHME	0	0	0	0			0
4.2.1	Grante të Tjera të Brendshme	0	0	0	0			0
4.3	GRANTE TË HUAJA	53,872	2,127	620	1,906.2	5,830.8	31,102.3	875.3
4.3.1	Grante të huaja	53,872	2,127	620	1,906.2	5,830.8	31,102.3	875.3


Të ardhurat nga burimet e veta vendore sipas Njësive Administrative

Pesha kryesore në realizimin e të ardhurave i ngarkohet Njesisë Administrative Shkodër, ose 58% të planit total të të ardhurave.

Tabela 5 Planifikimi i të ardhurave për vitet 2026-2028 sipas Njësive Administrative / mijë Lekë

Planifikimi i të ardhurave për vitet 2026-2028 sipas Njësive Administrative / mijë Lekë																		
Viti	Totali	Njësia Administrative Qendër						Njësi Administrative të tjera										
		Shuma	Lagje nr. 1	Lagje nr. 2	Lagje nr. 3	Lagje nr. 4	Lagje nr. 5	Shuma	Pult	Shosh	Shalë	Postribë	Guri i Zi	Bërdicë	Velipojë	Dajc	Ana e Malit	Rrethina
Plan 2026	1,344,391	783,690	168,584	161,278	159,731	151,792	142,305	560,701	546	717	5,935	7,283	10,084	15,965	479,662	9,946	6,285	24,278
Plan 2027	1,353,724	789,129	169,754	162,398	160,839	152,845	143,293	564,595	550	722	5,976	7,334	10,154	16,076	482,992	10,015	6,329	24,447
Plan 2028	1,344,802	783,930	168,635	161,329	159,779	151,838	142,349	560,872	546	717	5,937	7,285	10,087	15,970	479,809	9,949	6,287	24,285

SHPËRNDARJA E TË ARDHURAVE SIPAS NJËSIVE ADMINISTRATIVE



Grafik Shpërndarja e të ardhurave sipas Njësive Administrative Administrative

Të ardhurat nga Taksat Vendore


Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", me ndryshimet përkatëse, përbën ligjin bazë i cili përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësisve të qeverisjes vendore në drejtim të taksave vendore, mbledhjes dhe administrimit të tyre.

Për vitet 2026-2028 parashikohet që të ardhurat nga taksat vendore përbëjnë rreth 64% të të ardhurave nga burimet e veta të bashkisë.

Tabela 6 Të ardhurat nga taksat vendore

LLOJET E TË ARDHURAVE në 000/Lekë	Plan 2026	Plan 2027	Plan 2028
TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	859,950	863,151	865,036
TAKSA E PASURISË SË PALUAJTSHME	263,450	264,551	264,336
Taksa mbi Ndërtesën	198,714	199,714	200,000
Taksa mbi tokën bujqësore	22,299	22,299	21,736
Taksa mbi truallin	23,437	23,538	23,600
Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme	19,000	19,000	19,000
TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA	547,000	548,000	549,000
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	547,000	548,000	549,000
TAKSA TË TJERA VENDORE	49,500	50,600	51,700
Taksa vendore mbi biznesin e vogël	500	500	500
Taksa vendore në shërbimin hotelier	33,000	34,000	35,000
Taksa e tabelës	16,000	16,100	16,200
Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testamen...	0	0	0
Taksa e përkohëshme	0	0	0

Pjesë e rëndësishme në këtë kategori të taksave vendore janë të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme, e cila zë mbi 31% të totalit të të ardhurave nga taksat vendore, të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja me 63%, taksa e tabelës me 2% dhe taksa e fjetjes në hotel me 4%. Bazuar në Ligjin Nr. 68/2017 “PËR FINANCAT E VETËQEVERISJES VENDORE”, Neni 5 “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, në planin e të ardhurave për vitin 2026 janë parashikuar rreth 35,030 mijë lekë taksa vendore borxh nga subjektet debitorë.



Grafik 6 Të ardhurat nga taksat vendore

Të ardhurat nga Taksa e Pasurisë së Paluajtshme

Burimet Buxhetore	2023 Fakti	2024 Fakti	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2026 Plani	2027 Plani	2028 Plani
TAKSA E PASURISË SË PALUAJTSHME	205,978	206,122	267,668	267,668	263,450	264,551	264,336
Taksa mbi Ndërtesën	171,488	171,114	201,932	201,932	198,714	199,714	200,000
Taksa mbi tokën bujqësore	8,226	6,785	22,986	22,986	22,299	22,299	21,736
Taksa mbi truallin	15,614	18,644	23,750	23,750	23,437	23,538	23,600
Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme	10,650	9,579	19,000	19,000	19,000	19,000	19,000

Të ardhura nga Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Këto të ardhura përfshijnë të ardhurat nga :

- Taksa mbi ndërtesat (mbi ndërtesa banimi dhe ndërtesa biznesi)
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

Parashikimi për vitet 2026-2028 bazohet te zgjerimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- Saktësimi dhe vlerësimi të drejtë të sipërfaqeve nëpërmjet grupeve të punës të ngritura për këtë qëllim,
- Mbështetja nga agjentë tatimorë,
- Ndarjes në këste të pagesave për familjarët,
- Shtirje e mëtejshme e bazës taksapaguese, falë politikave fiskale lehtësuese dhe incentivave të ndërmarra, rivlerësimit të gjendjes faktike, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, si dhe bashkëpunimit me institucionin Agjencia e Kadastrës Shtetërore.

Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Planifikimi bëhet nga të dhënat e agjentit tatimor si dhe bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara referuar numrit të procedurave të tjetërsimit të pronës të kryera nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës ish-Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kapaciteti i pronës së taksueshme

Bazuar në rregjistrat aktual, në total, sipërfaqja ndërtesave që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të Bashkisë Shkodër është rreth 704,203 m².

Bizneset tregti dhe shërbime kanë rreth 77% të sipërfaqes totale të bizneseve të taksueshme.

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse për sipërfaqet e taksueshme të ndërtesave në pronësi të bizneseve, sipas Njësisve Administrative:

Kapaciteti i ndërtesave të bizneseve

Tabela 7 Kapaciteti i ndërtesave të bizneseve sipas kategorizimit

Bashkia Shkodër	Total Sip. ndërtesa biznesi m ²	Sip. Taksueshme biznesi tregti-shërbime m ²	Sip. Taksueshme biznesi prodhimi m ²
NjA Qendër	454,385	335,935	118,450
Lagjia nr.1	98,204	89,741	8,463
Lagjia nr.2	111,607	60,178	51,429
Lagjia nr.3	114,479	70,959	43,520
Lagjia nr.4	86,201	80,333	5,868
Lagjia nr.5	43,894	34,724	9,170
NjA të tjera	249,818	209,574	40,244
NjA Pult	18	18	-
NjA Shosh	1,397	1,397	-
NjA Shalë	16,305	15,881	424
NjA Postribë	10,032	8,526	1,506
NjA Guri i Zi	24,037	13,570	10,467
NjA Bërdicë	36,380	23,313	13,067
NjA Velipojë	5,421	5,020	401
NjA Velipojë Plazh	94,395	94,395	-
NjA Dajc	3,678	2,396	1,282
NjA Ana e Malit	3,208	3,109	99
NjA Rrethinat	54,947	41,949	12,998
TOTALI	704,203	545,509	158,694

Tabela 8 Kapaciteti i banesave të taksueshme

Bashkia Shkodër	Total sipërfaqe ndërtesa banimi m ² (përfshirë lehtësimin)
NjA Shkodër	2,717,538
Lagjia nr.1	589,195
Lagjia nr.2	563,813
Lagjia nr.3	513,050
Lagjia nr.4	563,813
Lagjia nr.5	487,667
NjA të tjera	1,926,154
Pult	14,409
Shosh	11,629
Shalë	19,858
Postrinë	292,360
Guri i Zi	156,945
Bërdicë	196,093
Velipojë	455,756
Dajç	242,438
Ana e Malit	133,125
Rrethinat	403,541
TOTALI	4,643,692

Tabela 9 Të dhena mesatare sipërfaqe e ndërtese për taksapagues sipas llojit, familjar dhe biznes

Bashkia Shkodër	Total Sipërfaqe ndërtese i taksueshëm, m²	Ndërtesë taksapagues familjar, m²	Ndërtesë taksapagues biznes, m²
NjA Shkodër	3,171,923	2,717,538	454,385
Lagjia nr.1	687,399	589,195	98,204
Lagjia nr.2	675,420	563,813	111,607
Lagjia nr.3	627,529	513,050	114,479
Lagjia nr.4	650,014	563,813	86,201
Lagjia nr.5	531,561	487,667	43,894
NjA të tjera	2,175,972	1,926,154	249,818
Pult	14,427	14,409	18
Shosh	13,026	11,629	1,397
Shalë	36,163	19,858	16,305
Postribë	302,392	292,360	10,032
Guri i Zi	180,982	156,945	24,037
Bërdicë	232,473	196,093	36,380
Velipojë	555,572	455,756	99,816
Dajc	246,116	242,438	3,678
Ana e Malit	136,333	133,125	3,208
Rrethinat	458,488	403,541	54,947
TOTALI	5,347,895	4,643,692	704,203

Kapaciteti i tokës bujqësore të taksueshme

Tabela 10 Kapaciteti i tokës bujqësore të taksueshme, sipas kategorisë së bonitetit

Nr	Bashkia Shkodër	Kat I	Kat II	Kat III	Kat IV	Kat V	Kat VI	Kat VII-X
1	NjA Pult	-	-	-	409	-	-	-
2	NjA Shosh	-	-	-	-	314	-	-
3	NjA Shalë	-	-	-	-	416	418	-
4	NjA Postribë	-	-	-	-	-	1,030	-
5	NjA Guri i Zi	-	-	-	1,965	-	-	-
6	NjA Bërdicë	-	-	-	2,151	-	-	-
7	NjA Velipojë	-	-	-	2,949	-	-	-
8	NjA Dajc	-	-	2,135	-	-	-	-
9	NjA Ana e Malit	-	-	886	887	-	-	-
10	NjA Rrethinat	-	-	-	-	2,481	-	-
	TOTALI	-	-	3,021	8,361	3,211	1,448	-

Efekti ekonomik i uljes së nivelit të taksës së pronës.

Bashkia Shkodër ka synuar mbajtjen e taksave në nivele të ulëta, deri në kufijtë e lejuar ligjor. Kështu, taksa e banesës dhe e ndërtesave për qëllime biznesi është ulur 30% në Njësitë Administrative, me një efekt prej 18,391 mijë Lekë në vit.

Taksa e tokës bujqësore është ulur deri në kufirin e lejuar 30% nga referenca ligjore. Efekti ekonomik i uljes së taksës së tokës bujqësore është 8,753 mijë Lekë/vit.

Në total, efekti ekonomik i uljes së taksave të pronës është 27,144 mijë Lekë në vit.

Tabela 11 Efekti ekonomik i uljes së taksës së ndërtesës dhe tokës bujqësore

Efektet financiare të uljes së taksës së pronës					000/leke
Emertimi	Njësi m2	Lekë/m2	Potenciali	Plani i të ardhurave	Efekti financiar
Banesa	4,643,692	20-29	112,843	95,300	17,543
Ndërtesa biznesi	704,203	24-122	104,262	103,414	848
Tokë bujqësore	16,041	0, 14-0,42	31,052	22,299	8,753
TOTAL			248,157	221,013	27,144

Të ardhurat nga Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja

	Burimet Buxhetore	2023 Fakti	2024 Fakti	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2026 Plani	2027 Plani	2028 Plani
1.2	TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA	65,703	176,295	297,000	297,000	547,000	548,000	549,000
1.2.1	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	65,703	176,295	297,000	297,000	547,000	548,000	549,000

Të ardhura nga Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Bashkia Shkoder, planin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë e ka bazuar në:

- Ligjin 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave”, i ndryshuar, taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja është përllogaritur duke marrë për bazë parashikimin e lejeve për ndërtime të reja në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor, miratuar me VKB nr.: 27, datë 20.04.2017 “Për miratimin e planit të zhvillimit të territorit dhe rregulloren e zbatimit të planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Shkodër” dhe me vendimin e KKT nr.5 date 16.10.2017 “ Per miratimin e planit te pergjithshem vendor si dhe në nismat Publike për hartim e PDV-ve, sipas Planit të Përgjithshëm Vendor, në disa njësi strukturore. Kjo në mbështetje të ligjit nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 686 datë 22.11.2017 “Për Miratimin

e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër, si dhe në interesin publik;

- Shlyerjen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukture të objekteve të legalizuara për objektet në process legalizimi, si dhe detyrime tatimore të pambledhura në kohë, prej më pak se 18 muaj nga afati i caktuar në legjislacionin në fuqi për pagesën e taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me ligjin. nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Realizimi i ardhurave nga kjo taksë lidhet dhe bazohet në zbatimin e masave shtrënguese, bllokimin e shërbimit të debitorëve nga Bashkia Shkodër, si dhe në mbështetjen nga Agjencia e Kadastres Shtetërore.

Efekti ekonomik i uljes së nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukture

Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, Bashkia Shkodër ka ulur nivelin e taksës nga 3% në 2% të vlerës së investimit për Njësitë Administrative .

Efekti ekonomik në total është rreth 87,000 mijë Lekë në vit.

Tabela 12 Efekti i lehtësive fiskale të taksës së ndikimit në infrastrukturë

Llogaritja e efektit financiar të lehtësimeve fiskale vendore ne 000/leke				
Efektet financiare të uljes taksës së ndikimit në infrastrukturë			000/leke	
Emertimi	Njësi	Potenciali	Plani i të ardhurave	Efekti financiar
Ndërtime për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industries apo për përdorim publik.	4-8%	524,000	447,000	77,000
Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike.	1-3%	30,000	20,000	10,000
TOTAL		554,000	467,000	87,000

Të ardhurat nga Taksa të Tjera Vendore

	Burimet Buxhetore	2023 Fakti	2024 Fakti	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2026 Plani	2027 Plani	2028 Plani
1.3	TAKSA TË TJERA VENDORE	42,620	52,912	47,000	47,000	49,500	50,600	51,700
1.3.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	1,898	2,558	1,000	1,000	500	500	500
1.3.2	Taksa vendore në shërbimin hotelier	26,609	33,960	30,000	30,000	33,000	34,000	35,000
1.3.3	Taksa e tabelës	14,113	16,394	16,000	16,000	16,000	16,100	16,200
1.3.4	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testamen...	0	0	0	0	0	0	0
1.3.5	Taksa e përkohëshme	0	0	0	0	0	0	0

Të ardhura nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Tatimi i thjeshtuar për biznesin e vogël administrohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore, e cila në rolin e agjentit tatimor mban një komision prej 1% të vlerës së mbledhur nga bizneset e vogla, ndërsa 99% kalon në favor të bashkisë Shkodër.

Të ardhura nga Taksa e fjetjes në hotel

Planifikimi i të ardhurave është bërë ju referuar kapacitetit aktual dhe parashakimit të zgjerimit të tij, rritjes së numrit të njësive, si dhe shtrirjen periudhave të sezoneve turistike për ushtrimin e aktivitetit.

Tabela 13 Të ardhura nga Taksa e fjetjes në hotel

Të dhënat e programit / Vitet	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
Numri i turistëve (i personave) të akomoduar në hotele	282,229	105,425	214,286	229,928	285,714	286,714	428,210	443,000	445,000	447,000
Të ardhura nga taksa e qëndrimit në hotel në 000/Lekë	19,756	7,380	12,967	18,408	26,609	33,960	30,000	33,000	34,000	35,000

Të ardhura nga Taksa e Tabelës



Parashikimi i të ardhurave bazohet në numrin e njërive takapaguese e në evidentimin e kapaciteteve të reja, si dhe në shtrirjen e mëtejshme të bazës taksapaguese dhe kërkesën për vendosje tabela reklamimi në akse kryesore rrugore.


Të ardhurat nga Tarifa Vendore

	Burimet Buxhetore	2023 Fakti	2024 Fakti	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2026 Plani	2027 Plani	2028 Plani
1.4	TARIFA VENDORE	358,162	374,072	457,712	457,712	440,302	445,324	434,517
1.4.1	Tarifa e menaxhimit të mbetjeve	184,424	180,171	220,320	220,320	206,645	206,845	206,914
1.4.2	Tarifa për zënien e hapësirës publike	57,061	66,721	65,000	65,000	53,000	53,100	53,200
1.4.3	Tarifa për ndriçimin publik	47,610	50,148	69,478	69,478	65,278	65,478	65,526
1.4.4	Tarifa për gjelbërimin	25,589	26,789	30,410	30,410	28,960	29,160	29,310
1.4.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	14,544	14,696	28,213	28,213	21,368	25,250	13,476
1.4.6	Tarifa të institucioneve të arsimit	15,859	17,081	22,351	22,351	22,301	22,301	22,301
1.4.7	Tarifa të institucioneve të kulturës dhe sportit	5,297	7,159	6,930	6,930	15,350	15,290	15,390
1.4.8	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	0	0	0	0	-	0	0
1.4.9	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	0	0	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000
1.4.10	Tarifa e përkohëshme	0	0	0	0	-	0	0
1.4.11	Tarifa e parkimit	7778	11307	11000	11000	21,000	21,500	22,000
1.4.12	Tarifa të tjera	0	0	10	10	2400	2400	2400

Referuar ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 35/5, bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifat vendore për: shërbimet publike që ato ofrojnë; dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj. Gjithashtu bashkitë mund të krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive, dhe të tjera, të përcaktuara me ligj.

Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikat dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet në fuqi.

Peshën më të madhe në kategorinë e të ardhurave nga tarifat vendore e zënë të ardhurat nga tarifat për ofrimin e shërbimeve publike të pastrimit e largimit të mbeturinave me 47% të totalit të tarifave, duke qenë edhe një nga aktivitetet kryesore në funksionin e shërbimeve publike, të gjelbrimit me 6.5%, të ndriçimit publik me 15%, të tarifës së hapësirës publike me 12%, të shërbimit administrativ të bashkisë me 5%, të institucioneve të arsimit me 5% dhe të institucioneve të kulturës dhe sportit me 3% etj. Bazuar në Ligjin Nr. 68/2017 "PËR FINANCAT E VETËQEVERISJES VENDORE", Neni 5 "Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore", në planin e të ardhurave për vitin 2026 janë parashikuar rreth 45,247 mijë lekë tarifa vendore borxh nga subjektet debitorë.



Grafik 7 Raporti i tarifave vendore mbi totalin e të ardhurave

Të ardhura nga tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit.

Parashikimi i të ardhurave nga tarifatat për pastrimin, ndriçimin dhe gjelbërimin, bazohet tek kapaciteti aktual dhe në rritjen e njësive taksapaguese e në evidentimin e kapaciteteve të reja, si dhe në shtrirjen e mëtejshme të bazës taksapaguese falë politikave fiskale lehtësuese, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, fokusimit në zona me kapacitete të pasfrytëzuara, si dhe sensibilizimin dhe trajtimin e biznesit si partner në dhënien e shërbimeve për komunitetin.

Kontribuesit e taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjitha njësive administrative. Për përcaktimin e numrit të tyre janë konsideruar të dhënat e regjistrave për taksapaguesit, si dhe përjashtimet apo lehtësitë fiskale sipas paketës fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Në total kapaciteti i taksapaguesve është parashikuar rreth 41,475 (familje, biznese dhe institucione). Peshën numerike më të madhe të taksapaguesve e përbëjnë familjet, rreth 85%.

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse e kapacitetit të taksapaguesve sipas kategorive dhe njësive administrative.

Kapaciteti i taksapaguesve sipas grupeve

Tabela 14 Kapaciteti i taksapaguesve sipas grupeve

KAPACITETI I TAKSAPAGUESVE SIPAS GRUPIMEVE (Numri)			
Nr	Bashkia Shkodër	Familje	Biznese
I	Njësia Administrative Shkodër	21,253	4,733
1	Lagjia nr.1	4,745	1,414
2	Lagjia nr.2	4,231	873
3	Lagjia nr.3	4,399	1,020
4	Lagjia nr.4	4,698	1,052



5	Lagjia nr.5	3,180	374
II	Njësi Administrative të tjera	14,172	1,317
1	NjA Pult	334	2
2	NjA Shosh	80	13
3	NjA Shalë	477	93
4	NjA Postrisë	1,609	91
5	NjA Guri i Zi	1,907	133
6	NjA Bërdicë	1,425	152
7	NjA Velipojë	1,270	326
8	NjA Dajc	1,152	63
9	NjA Ana e Malit	1,017	66
10	NjA Rrethinat	4,901	378
	TOTALI	35,425	6,050

Taksapaguesit familjarë

Parashikimi i të ardhurave nga familjet është bërë duke iu referuar kapaciteteve reale të familjeve rezidente sipas Censurit, si dhe lehtësive fiskale të miratuara.

Në total numri i familjeve që përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të Bashkisë Shkodër është 35,425. Në paketën fiskale të Bashkisë Shkodër janë parashikuar lehtësi fiskale dhe numri i këtyre familjeve arrin në 8,149 familje si pensionistë, invalid, familje me ndihmë ekonomike, familje njëprindërore, familje me probleme sociale etj. Ato zënë 23% të numrit të përgjithshëm të familjeve në Bashkinë Shkodër.



Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse për familjet sipas kategorive/lehtësive fiskale dhe sipas Njësive Administrative:

Tabela 15 Kapaciteti i familjeve taksapaguese sipas grupimeve

Nr	Bashkia Shkodër	Totali i familjeve	Familje me taksa/tarifatëplota	Familje me lehtësi fiskale	Me lehtësi fiskale: Pensionistë, invalidë etj.	Me lehtësi fiskale: nd.ekonomike.
I	NjA Qendër	20,415	14,804	5,611	5,396	215
1	Lagjia nr.1	4745	3,422	1323	1267	56
2	Lagjia nr.2	4231	3,183	1048	1025	23
3	Lagjia nr.3	4399	3,386	1013	999	14
4	Lagjia nr.4	4698	3,561	1137	1,043	94
5	Lagjia nr.5	2342	1,252	1090	1062	28
II	NjA të tjera	15,010	12,472	2,538	1,377	1,161
1	NjA Pult	333	673	143	4	51
2	NjA Shosh	68			3	29
3	NjA Shalë	415			15	41
4	NjA Postrisë	1793	1211	582	176	406



5	NjA Guri i Zi	2090	1756	334	165	169
6	NjA Bërdicë	1543	1206	337	259	78
7	NjA Velipojë	1322	1096	226	171	55
8	NjA Dajç	1144	1083	61	41	20
9	NjA Ana e Malit	1074	906	168	101	67
10	NjA Rrethinat	5228	4541	687	442	245
	TOTALI	35,425	27,276	8,149	6,773	1,376



Grafik 8 Shpërndarja e popullsisë në Bashkinë Shkodër

Taksapaguesit biznese dhe institucione

Bazuar në regjistrat aktual, në total, numri i bizneseve dhe institucioneve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të Bashkisë Shkodër është 6,050. Biznesi me xhiro 0-8milion zë rreth 72% të numrit total të bizneseve.


Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse për bizneset dhe institucionet, sipas Njësive Administrative:

Kapaciteti i bizneseve dhe institucioneve taksapaguese


Tabela 16 Kapaciteti i bizneseve dhe institucioneve taksapaguese

KAPACITETI I BIZNESEVE DHE INSTITUCIONEVE TAKSAPAGUESE

Nr	Bashkia Shkodër	Totali	Biznes me xhiro 0-8 milion	Biznes me xhiro mbi 8 milion	Institucione
I	NjA Qendër	4,733	3,370	1,304	59
	Lagjia nr.1	1414	1075	322	17
	Lagjia nr.2	873	593	269	11
	Lagjia nr.3	1020	709	301	10
	Lagjia nr.4	1052	742	292	18
	Lagjia nr.5	374	251	120	3
II	NjA të tjera	1,317	961	350	6
	NjA Pult	2	2	0	0
	NjA Shosh	13	12	1	0
	NjA Shalë	93	79	14	0
	NjA Postrisë	91	72	19	0
	NjA Guri i Zi	133	102	30	1
	NjA Bërdicë	152	82	70	0
	NjA Velipojë	326	258	67	1
	NjA Dajc	63	32	31	0
	NjA Ana e Malit	66	50	16	0
	NjA Rrethinat	378	272	102	4
	TOTALI	6,050	4,331	1,654	65



Grafik 9 Shpërndarja e biznesit në Bashkinë Shkodër



Grafik 10 Raporti i bizneseve sipas xhiros


Në tabelën e mëposhtme, për bizneset me xhiro 0-8 milion vihet re pesha e madhe që zë aktiviteti tregti dhe shërbime me 89% ndaj totalit.

Nr	Bashkia Shkodër	Biznes me xhiro 0-8 milion	Nga kjo :			
			Njësi tregtare dhe shërbimi	Njësi prodhimi	Profesione te lira	Ambulantë
I	NjA Shkodër	3,370	2,974	59	227	110
	Lagjia nr.1	1075	1005	18	47	5
	Lagjia nr.2	593	526	14	45	8
	Lagjia nr.3	709	579	6	32	92
	Lagjia nr.4	742	630	11	96	5



	Lagjia nr.5	251	234	10	7	0
II	NjA të tjera	961	874	56	17	14
	Pult	2	2	0	0	0
	Shosh	12	12	0	0	0
	Shalë	79	79	0	0	0
	Postribë	72	65	6	1	0
	Guri i Zi	102	95	5	2	0
	Bërdicë	82	70	12	0	0
	Velipojë	258	235	6	3	14
	Dajç	32	26	5	1	0
	Ana e Malit	50	45	4	1	0
	Rrethinat	272	245	18	9	0
	TOTALI	4,331	3,848	115	244	124

Tabela 17 Kapaciteti i bizneseve te vogla sipas natyres se tyre



Grafik 11 Kapacitetet e biznesit të vogël

Në tabelën e mëposhtme, për bizneset me xhiro mbi 8 milion lekë vihet re pesha e madhe që zë aktiviteti tregti dhe shërbime me 68% ndaj totalit.


Tabela 18 Kapaciteti i bizneseve te medha sipas natyres se tyre

KAPACITETI I BIZNESEVE ME XHIRO MBI 8 MILION SIPAS NATYRES SE TYRE

		Biznesim e xhiro mbi 8 milion	Nga kjo :					Institucion e
			Njësi tregëtar e dhe shërbimi	Njësi tregtare për tregëtim karburant i	Njësi prodhim i	Subjekt e ndërtim i	OJ F	
	Bashkia Shkodër							



I	NjA Shkodër	1,304	890	21	114	76	144	59
	Lagjia nr.1	322	230	11	20	15	29	17
	Lagjia nr.2	269	183	3	44	14	14	11
	Lagjia nr.3	301	198	2	23	21	47	10
	Lagjia nr.4	292	208	2	13	19	32	18
	Lagjia nr.5	120	71	3	14	7	22	3
I I	NjA të tjera	350	235	21	45	22	21	6
	Pult	0	0	0	0	0	0	0
	Shosh	1	1	0	0	0	0	0
			dhe buxhetin lokal të njësisë vendore.	investimeve dhe shërbimeve bazë, ndërsa zonat urbane përballen me sfida infrastrukturore dhe sociale. 5. Rritje e shpenzimeve për infrastrukturë në zonat urbane: Rritja e popullsisë në qytet rrit nevojën për infrastrukturë të re, si strehim, shkolla, shërbime shëndetësore, dhe transport, duke shkaktuar shpenzime të mëdha për buxhetin vendor.			punëtore të qëndruesh me. 3. Zhvillimi i shërbimeve të përshatur a për popullsinë e plakur: Krijimi i programev e të përshatura për nevojat e popullsisë së moshuar, si shërbimet e kujdesit në shtëpi dhe infrastruktura e qendrave shëndetësore, ndihmon në përballimin e kërkesës për kujdes. 4. Përmirësimi i planifikimit urban dhe rural: Planifikimi i qëndrueshëm urban dhe investimi në zhvillimin e zonave rurale mund të ulë presionin mbi qytetin dhe të mbajë një shpërndarje më të barabartë të popullsisë.
--	--	--	--	--	--	--	---



							5. <i>Zhvillimi i politikave për nxitjen e migrimit të kualifikuar :</i> Politikat që tërheqin emigrantë të kualifikuar mund të kompensojnë në mungesën e fuqisë punëtore dhe të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe social të komunitetit lokal. 6. <i>Nxitja e përfshirjes ekonomike dhe sociale të popullsisë:</i> Fuqizimi i përfshirjes së grave, të moshuarve dhe individëve të grupeve të tjera në tregun e punës dhe në aktivitete ekonomike ndihmon në zvogëlimin e efekteve negative të ndryshimeve demografike.
--	--	--	--	--	--	--	--

							Ndryshime t demografik e përbëjnë një sfidë afatgjatë për financat publike dhe për qëndruesh mërinë ekonomike të njësisë vendore. Menaxhimi efektiv i këtij rreziku kërkon politika dhe masa të mirëplanifi kuara që u përshtaten ndryshime ve në strukturën e popullsisë. Përmes përmirësim it të shërbimeve , mbështetje s për të rinjtë dhe përfshirjes së të gjithë grupeve të popullsisë në ekonomi, njësia vendore mund të minimizojë ndikimet negative të këtij rreziku dhe të promovojë një zhvillim të qëndrueshë m
--	--	--	--	--	--	--	---

							ekonomik dhe social.
1 7.	Paqartësi në legjislacionin, aktet nënligjore dhe rregullore fiskale	Paqartësi ose interpretime të ndryshme ose të gabuara të legjislacionit, akteve nënligjore dhe rregulloreve fiskale, të cilat shkaktojnë konfuzion dhe përplasje në zbatimin e tyre. Rreziku i paqartësive në legjislacionin, aktet nënligjore dhe rregulloret fiskale përbën një sfidë të rëndësishme për njësinë vendore, bizneset dhe individët, pasi legjislacioni fiskal jo i qartë ose i interpretuar në mënyra të ndryshme krijon pasiguri dhe vështirësi në zbatimin korrekt të politikave tatimore dhe fiskale. Kjo mund të sjellë probleme në mbledhjen e të ardhurave, rritjen e	1. Ndryshime të shpeshta në legjislacionin fiskal: Ndryshimet e shpeshta ose të papritura në ligjet fiskale dhe tatimore e bëjnë të vështirë për njësinë vendore dhe tatimpaguesit të ndjekin dhe të kuptojnë detyrimet e tyre fiskale. 2. Interpretime të ndryshme të ligjeve/rregulloreve: Legjislacioni/Rregulloret fiskale që janë të përgjithshme ose të lëshuara pa udhëzime specifike mund të interpretohen në mënyra të ndryshme nga institucionet dhe tatimpaguesit, duke krijuar paqartësi në zbatimin e tyre. 3. Mungesa e transparencës dhe udhëzimeve të detajuara: Mungesa e udhëzimeve të detajuara dhe shembujve konkretë për zbatimin e legjislacionit/rregulloreve lë hapësira për paqartësi dhe shpesh kërkon konsultim të shpeshtë me autoritetet fiskale për sqarime.	1. Mbledhje e ulët e të ardhurave fiskale: Paqartësitë në legjislacion/rregullore mund të çojnë në mbledhje të ulët të të ardhurave, pasi tatimpaguesit mund të mos e dijnë saktësisht se çfarë detyrimesh kanë ose të mos i paguajnë taksat në kohë. 2. Rritje e konfliktëve tatimore dhe kostove ligjore: Paaftësia për të interpretuar legjislacionin/rregulloret në mënyrë uniforme mund të çojë në më shumë mosmarrëveshje tatimore midis autoriteteve dhe tatimpaguesve, çka rrit kostot për zgjidhjen e këtyre çështjeve. 3. Humbje e besimit tek Institucioni vendor dhe rritje e shmangies së taksave: Paaftësia e institucionit vendor për të siguruar qartësi në legjislacionin/rregulloret e zbatueshme ul besimin e publikut dhe nxit	I mesëm	I mesëm	Sqarimi dhe azhurnimi i legjislacionit, akteve nënligjore e rregullorev e fiskale si dhe trajnimi i stafit për implementimin (zbatimin) korrekt të tyre. Dhe konkretisht: 1. Përmirësimi i komunikimit dhe transparencës: Institucioni vendor mund të rrisë transparencën duke ofruar udhëzime të qarta, shembuj praktikë, dhe komunikim të hapur me publikun për të sqaruar detyrimet fiskale. 2. Harmonizimi i rregullorev e vendore dhe qendrore: Bashkëpunimi mes qeverisjes vendore



		detyrimeve të prapambetur a dhe shmangien e taksave, duke prekur kështu qëndrueshmërinë financiare të njësisë vendore dhe besimin e publikut.	4. Ligje dhe rregullore që konfliktikojnë me njëra-tjetrën: Mungesa e harmonizimit mes rregulloreve vendore dhe atyre qendrore mund të krijojë konflikte dhe pasiguri në zbatimin e legjislacionit/rregulloreve për mbledhjen e taksave dhe tarifave. 5. Kompleksiteti i lartë i legjislacionit fiskal: Legjislacion/rregullore që janë komplekse ose teknike e bëjnë të vështirë për tatimpaguesit të kuptojnë dhe të zbatojnë në mënyrë të saktë detyrimet e tyre fiskale.	tatimpaguesit të kërkojnë mënyra për të shmangur taksat ose për të minimizuar detyrimet e tyre. 4. Vështirësi në planifikimin financiar: Njësia vendore mund të ndeshet në vështirësi në lidhje me planifikimin dhe buxhetimin financiar, pasi paqartësitë në rregulloret fiskale mund të ndikojnë në parashikimet e sakta për të ardhurat. 5. Rritje e detyrimeve të prapambetura: Për shkak të pasigurisë dhe paqartësive, tatimpaguesit mund të shtyjnë pagesat, çka çon në krijimin e detyrimeve të prapambetura dhe rrjedhimisht në uljen e likuiditetit të njësisë vendore.		dhe asaj qendrore për harmonizimin e rregulloreve dhe ligjeve ndihmon në shmangien e konflikteve dhe siguron që legjislacioni i është i unifikuar dhe i qartë. 3. Ndërmarrja e rishikimeve periodike të rregulloreve fiskale: Për të siguruar që rregulloret janë të përshtatshme dhe të qarta, është e rëndësishme që ato të rishikohen periodikisht dhe të përshtaten me zhvillimet ekonomike dhe fiskale. 4. Përgatitja e trajnimeve dhe seancave të këshillimit për tatimpaguesit: Ofrimi i trajnimeve dhe seminareve
--	--	---	--	--	--	--

						për tatimpague sit për të kuptuar më mirë rregulloret fiskale ndihmon në zbatimin e drejtë të ligjit dhe redukton paqartësitë. 5. Krijimi i platformave dixhitale për interpretim in dhe konsultimi n e rregulloreve: Përdorimi i platformave online ku tatimpague sit mund të konsultojnë rregulloret dhe të marrin sqarime në kohë reale ndihmon në përmirësimin e qartësisë dhe transparencës. 6. Përforcimi i kapaciteteve të administratës tatimore: Trajnimi i vazhdueshëm i stafit të administratës tatimore në zbatimin dhe interpretimin e ligjeve
--	--	--	--	--	--	--

							dhe rregullorev e ndihmon në ofrimin e shërbimeve më të mira dhe në reduktimin e konflikteve të mundshme. Paaftësia për të kuptuar dhe interpretuar saktësisht rregulloret fiskale sjell rreziqe të mëdha për njësinë vendore dhe për tatimpague sit. Përmes përmirësim it të transparencës, harmonizimit të legjislacionit dhe zhvillimit të udhëzimeve të detajuara, njësia vendore dhe institucione t tatimore mund të ulin pasigurinë, të rrisin të ardhurat dhe të përmirësojnë besimin e publikut në sistemin fiskal.
--	--	--	--	--	--	--	--



4. Monitorimi i zbatimit të strategjisë së Zhvillimit të njësive

4.1 Hyrje – rezultati i përgjithshëm dhe përfundime

Hartimi dhe zbatimi i Strategjisë Territoriale të Bashkisë Shkodër përbën një nga instrumentet më të rëndësishme për orientimin e zhvillimit afatgjatë të territorit, duke synuar identifikimin, shfrytëzimin dhe valorizimin e burimeve vendore, ideve inovative dhe potencialeve njerëzore për të nxitur rritjen ekonomike, sociale dhe territoriale të bashkisë. Ky dokument strategjik shërben si një udhërrëfyes për zhvillimin e qëndrueshëm, duke ndërlidhur planifikimin hapësinor me prioritetet e zhvillimit ekonomik dhe social të komunitetit.

Procesi i zbatimit të strategjisë shoqërohet me monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të saj, të cilat përbëjnë një mekanizëm thelbësor të qeverisjes së mirë, me qëllim të matjes së progresit, transparencës dhe llogaridhënies publike. Monitorimi synon të vlerësojë nëse burimet financiare, njerëzore dhe institucionale të vëna në dispozicion janë të mjaftueshme, janë përdorur me efikasitet dhe efektivitet, dhe nëse veprimet e planifikuara po realizohen sipas objektivave të përcaktuara në dokumentin strategjik.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit është përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të Strategjisë Territoriale të Bashkisë Shkodër. Periudha e raportimit për këtë fazë të monitorimit mbulon kohën nga miratimi i planit deri në muajin nëntor 2025. Gjatë kësaj periudhe, objektivat strategjikë të përcaktuar në strategji kanë shërbyer si bazë për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026–2028, duke siguruar koherencë dhe lidhje funksionale midis planifikimit strategjik dhe atij buxhetor. Në këtë mënyrë, është garantuar që prioritetet zhvillimore të përfshihen në programet buxhetore të Bashkisë Shkodër, dhe që ndarja e burimeve financiare të bëhet në përputhje me objektivat dhe planin e veprimit të strategjisë.


Në zbatim të këtij parimi, është ndërtuar kuadri logjik i PBA-së, ku projektet janë integruar sipas objektivave strategjikë dhe fushave përkatëse të ndërhyrjes. Monitorimi i ecurisë së zbatimit është bazuar në të dhëna të verifikuara zyrtarisht, të mbledhura nga drejtoritë e linjës, njësitë e varësisë, si dhe nga raportet e zbatimit të buxhetit të viteve 2024–2025 të Bashkisë Shkodër.

Procesi i monitorimit të Strategjisë Territoriale është strukturuar në dy komponentë kryesorë:

1. Monitorimi i ecurisë së zbatimit, që fokusohet në gjurmimin e aktiviteteve, projekteve dhe përdorimit të burimeve;
2. Monitorimi i rezultateve, që mat ndikimin dhe rezultatet konkrete të arritura në raport me objektivat strategjikë të përcaktuar.

Rezultatet e monitorimit ofrojnë një pasqyrë të përgjithshme të progresit, identifikojnë sfidat dhe boshllëqet gjatë procesit të zbatimit dhe shërbejnë si bazë për rishikimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të politikave dhe planeve zhvillimore të Bashkisë Shkodër.

Dokumenti strategjik i Bashkisë Shkodër përbëhet nga:



Struktura e strategjisë territoriale të Bashkisë Shkodër:

VIZIONI																																					
OS1				OS2				OS3								OS4												OS5									
P51	P52	P53	P54	P51	P52	P53	P54	P55	P51	P52	P53	P54	P55	P56	P51	P52	P53	P54	P55	P56	P57	P58	P59	P510	P511	P512	P513	P514	P515	P51	P52	P53	P54	P55	P56	P57	P58
P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1	P1
P2	P2	P2	P2			P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2	P2			P2	P2	P2	P2	P2	P2					P2	P2
P3	P3	P3	P3				P3		P3	P3	P3	P3	P3	P3	P3											P3	P3	P3	P3	P3	P3						P3
P4		P4					P4			P4	P4	P4	P4	P4	P4						P4	P4									P4						P4
P5			P5							P5	P5	P5	P5	P5		P5																					
		P6					P6			P6	P6		P6	P6	P6					P6																	
		P7						P7			P7	P7	P7	P7																							
		P8							P8	P8		P8	P8	P8																							
		P9							P9	P9		P9	P9	P9																							
		P10							P10	P10		P10	P10	P10																							
								P11	P11					P11																							
									P12					P12																							
									P13					P13																							
									P14					P14																							
									P15					P15																							
									P16					P16																							
									P17					P17																							
									P18					P18																							
									P19					P19																							
									P20					P20																							
									P21					P21																							
									P22					P22																							
									P23					P23																							
									P24					P24																							
									P25					P25																							
														P26																							

4.2 Lista e masave strategjike për çdo fushë prioritare – statusi i shpenzimit

Zbatimi i **Strategjisë Territoriale të Zhvillimit të Bashkisë Shkodër** mbështetet në një kombinim burimesh financiare të siguruara nga **programi buxhetor afatmesëm (PBA)**, fondet e **qeverisë qendrore**, si dhe mbështetjet e **donatorëve dhe partnerëve ndërkombëtarë të zhvillimit**.

Programi Buxhetor Afatmesëm i Bashkisë Shkodër (2025–2027), së bashku me transfertat dhe grantet nga **qeveria qendrore** (Fondi Shqiptar i Zhvillimit, ministritë përkatëse, etj.), përbën burimin kryesor të financimit për zbatimin e planit të investimeve të bashkisë. Këto fonde janë të orientuara kryesisht në **zhvillimin e infrastrukturës rrugore, përmirësimin e shërbimeve publike dhe rehabilitimin urban e rural**, duke mundësuar një zhvillim të **qëndrueshëm dhe të balancuar të territorit**.

Përveç fondeve shtetërore, **donatorët ndërkombëtarë si Bashkimi Evropian, Banka Botërore dhe agjenci të tjera ndërkombëtare** kanë kontribuar në **projekte me ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e mjedisit, menaxhimin e mbetjeve, trajtimin e ujërave të ndotura, ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe asistencën teknike**. Këto mbështetje kanë luajtur një rol thelbësor në realizimin e **nismave afatgjata për zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor të Bashkisë Shkodër**, duke garantuar një qasje gjithëpërfshirëse në drejtim të përmbushjes së objektivave strategjike.

Në procesin e zbatimit të strategjisë, **Plani i Investimeve Kapitale (PIK)** ka shërbyer si **instrument referimi** për planifikimin dhe ndarjen e burimeve. Ky plan përmban të gjitha **projektet kapitale të parashikuara në strategji**, duke përcaktuar për secilën:

- prioritetin zhvillimor;
- afatin kohor të zbatimit;
- burimin e financimit.

Në këtë kuadër, **financimi i zbatimit të strategjisë** është mbështetur në dy komponentë kryesorë:

- **Kostot e planifikimit** të projekteve të strategjisë (studime, projekte teknike, plane zbatimi, etj.);
- **Kostot reale të investimeve** të parashikuara për zbatim (përfshirë infrastrukturën, mjedisin, shërbimet sociale, kulturën dhe turizmin).

Megjithatë, duhet theksuar se **jo të gjitha projektet e listuara në planin e investimeve kanë të përcaktuar vlerën e plotë të financimit** në këtë fazë të zbatimit. Kjo ndodh për disa arsye:

- Strategjia e zhvillimit të territorit ka një **kohështrirje afatgjatë (2015–2030)**, çfarë nënkupton që disa projekte do të financohen në periudha të ndryshme;
- Disa projekte janë **të ndërlidhura me përfundimin e projekteve të tjera zinxhir**, duke e bërë të nevojshme përcaktimin gradual të kostove;
- Ka projekte me **natyrë komplekse apo specifike teknike**, për të cilat kërkohet studim i mëtejshëm i fizibilitetit dhe përcaktim i burimeve të financimit në faza të mëvonshme.

Në përfundim, **statusi i shpenzimeve** tregon se zbatimi i masave strategjike është mbështetur kryesisht nga **burimet e brendshme të Bashkisë** dhe nga **partneritetet qendrore e ndërkombëtare**, duke reflektuar një **qasje të integruar financimi** që siguron vazhdimësinë e projekteve dhe përmbushjen e synimeve të zhvillimit të territorit të Bashkisë Shkodër.

Sa mësipër, monitorimi i zbatimit të projekteve u bë duke u mbështetur në një shkallë vlerësimi prej tre vlerash kryesore:


- E ulët - Programet që kanë më pak se 10% të projekteve të zbatuara janë vlerësuar me ecuri të ulët zbatimi (ngjyrë të kuqe).
- E mesme - Programet që kanë nga 11% deri në 50% të projekteve të zbatuara janë vlerësuar me ecuri të mesme zbatimi (ngjyrë të verdhë).
- E mirë - Programet që kanë mbi 51% të projekteve të zbatuara janë vlerësuar me ecuri të mirë zbatimi. (ngjyrë të jeshile).

Gjendja e zbatimit të programeve të dokumentit strategjik

Zbatimi i Strategjisë së Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Shkodër ka njohur nivele të ndryshme përparimi, në varësi të natyrës së programeve, burimeve financiare të disponueshme dhe prioriteteve strategjike të bashkisë. Në analizën e përgjithshme janë


monitoruar 5 objektiva strategjikë, të cilët përfshijnë gjithsej 198 projekte të planifikuara në kuadër të këtij dokumenti.

Tabela 2: Struktura e objektivave strategjikë:



Nga 198 projekte të monitoruara, të cilat kanë një afat zbatimi 2015-2030, konstatohet se:

- 33 % projekteve janë vlerësuar me ecuri të ulët zbatimi, rreth 67 projekte;
- 46 % e projekteve janë vlerësuar me ecuri të mesme zbatimi, rreth 90 projekte;
- 21 % e projekteve janë vlerësuar me ecuri të lartë zbatimi, rreth 41 projekte.



Ecuria e monitorimit të strategjisë territoriale të Bashkisë Shkodër:

4.3 Investimet publike strategjike në nivel vendor-

Grant/ndihmë - janë të ardhura të përfituara në formën e dhurimit, pa kusht kthimi, pa interes, për një qëllim të përcaktuar ose jo, e cila përdoret për financimin e veprimtarive në përputhje me politika të caktuara dhe që jepen mbi bazën e marrëveshjeve përkatëse nga institucione financiare, organizma të huaj, qeveri të vendeve të tjera etj., dhe marrëveshje për grante ndërkombëtare sipas aplikimeve në thirrje të ndryshme.

Ministria përgjegjëse për financat kontrollon, regjistron dhe raporton të gjitha transaksionet që lidhen me huat, kreditë dhe grantet. NJQP-të paraqesin, pranë strukturës përgjegjëse për buxhetin, kërkesat për përfshirje në programin buxhetor afatmesëm (PBA), në të cilin identifikohen me kod të veçantë produkti sipas klasifikimit funksional buxhetor. NJQP-të janë të detyruara t'i raportojnë ministrisë përgjegjëse për financat të dhënat e kërkuara të financimeve të huaja, brenda afateve të caktuara. Realizimi i huave, kredive dhe granteve me financim të huaj do të jenë pjesë përbërëse e buxhetit faktik vjetor që miratohet në Këshill Bashkiak.

Projektet me sistem të pjesshëm Thesari, mjetet monetare, të transferuara nga kreditë dhe grantet, do të regjistrohen si flukse hyrëse në llogaritë bankare speciale, të hapura në emër të ministrisë përgjegjëse për financat dhe të specifikuara për çdo projekt të financimit të huaj.


Projektet me sistem të plotë Thesari, mjetet monetare, të transferuara nga kreditë dhe grantet, do të regjistrohen si flukse hyrëse në llogarinë e unifikuar të Thesarit “Depozitë e qeverisë” (TSA) në Bankën e Shqipërisë nëpërmjet transitimit nga llogaritë bankare speciale, të hapura në emër të ministrisë përgjegjëse për financat dhe të specifikuara, për çdo projekt të financimit të huaj në Bankën e Shqipërisë.

Në zbatim të vizionit për *“Shkodrën qendër të rëndësishme kombëtare e rajonale, një bashki me cilësi të mirë jetese për banorët e vet dhe mikpritëse për vizitorët”* një sërë projektesh strategjike do të realizohen përmes mbështetjes me fonde nga Qeveria Shqiptare dhe donatorë të huaj. Investimet janë të shtrira në të gjithë territorin nga Alpet në Bregdet duke synuar një përmirësim rrënjësor të infrastrukturës e cila do të përkthehet në një zhvillim të qëndrueshëm social ekonomik për banorët, bizneset dhe vizitorët.

Në kuadër të këtij angazhimi, kemi arritur disa rezultate të rëndësishme për realizim të vizionit **SHKODRA KRYEQËNDËR RAJONALE**.

Një angazhim ambicioz i cili fokusohet tek:

- ✓ **Shkodra në Punë:** Mundësi të reja pune për qytetarët, mbështetje për bizneset lokale dhe inkurajim i investimeve në sektorët e rinj ekonomikë.
- ✓ **Shkodra në Zhvillim:** Infrastrukturë dhe shërbime efikase që stimulojnë rritjen e ekonomisë, përmirësojnë cilësinë e jetesës dhe e bën Shkodrën një qytet tërheqës për investitorët dhe turistët.
- ✓ **Shkodra 2030:** Zbatimi i projekteve që modernizojnë qytetin, duke ruajtur dhe respektuar historinë dhe kulturën e tij.
- ✓ **Shkodra Moderne:** Krijimi i një qyteti tërheqës për jetesë, ku teknologjia dhe inovacioni janë në thelb të zhvillimit



Për realizimin e vizionit **Shkodra Kryeqendër Rajonale** planifikimi dhe zbatimi buxhetor si dhe bashkëpunimi me qeverinë dhe donatorët kërkon angazhim dhe profesionalizëm të stafit të Bashkisë, burimeve financiare të ndryshme si dhe kohë/afate të zbatimit. Shumë nga projektet e iniciuara kanë afate mbi 2-3 vjeçare zbatimi, por përcaktimi i qartë i vizionit të zhvillimit të Bashkisë Shkodër ka bërë që tashmë Shkodra të jetë një kantier i hapur punësh infrastrukturore të cilat prekin çdo banorë, biznes apo vizitor të saj. Si më poshtë vijojnë paraqesim listën me **50 investimet kryesore** të përfunduara dhe atyre që do të jenë në zbatim përgjatë PBA 2026 – 2028 për transformimin e Shkodrës 2030.

I. Projektet Transformuese Shkodra 2030

1. Rruga Shëngjin – Velipojë (Përfunduar)

Një nga Rrugët panoramike më të bukura në Shqipëri e cila ka hapur një etapë të re për zhvillimin e turizmit në zonën Shëngjin - Velipojë duke shkurtuar kohën e udhëtimit për pushuesit.



2. Ndërtim i urës së Bahçallekut dhe rindërtim aksi Bërdicë Hyrje Shkodër (Në Proces)

Lëvizshmërisë e lartë në këtë rrugë si dhe në urën e Bahçallekut kërkon që të bëhen ndërhyrje infrastrukturore që lehtësojnë trafikun. Ky investim i financuar plotësisht nga Qeveria Shqiptare me një vlerë prej rreth 8.4 milion eurosh përfshin zgjerimin e rrugës në 4 korsi, ndërtimin e trotuareve, ndërtimin e një ure të dytë mbi Drin paralel me urën ekzistuese të Bahçallëkut dhe përmirësimin e nyjeve të Harku i Bërdicës dhe tek Ura e re e Bunës.

Punimet, të cilat janë në një fazë të mirë zbatimi, do të kenë një ndikim të madh në zbutjen e trafikut e radhëve të gjata sidomos gjatë sezonit veror. Si bashki po punojmë ngushtë me ARRSH-në për të siguruar një projekt sa më funksional e të sigurt për të gjithë përdoruesit, banorët dhe bizneset përgjatë rrugës.



Parku i Liqenit dhe lumi Buna

Paketë investimesh në proces për përmirësimin e infrastrukturës dhe ambientit të zonës së liqenit Shkodër, Parkut të Bexhistenit dhe rrugës Ura e Bunës Shirokë për krijimin e një zonë atraktive për banorët dhe turistët.

3. Ndërhyrje në parkun e hyrjes së Shkodrës dhe rikualifikimi i bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës (Në Proces)



4. Rikualifikim i zonës Turistike Hyrja Shkodër Shirokë (Në Proces)



5. Rikonstruktion Rruga Ura e Bunës – Shirokë (Në Proces)




6. Rikualifikim qendër Zogaj (Në Proces)

Projekti është ndër ndërhyrjet që do të ndryshojë imazhin urban të fshatit Zogaj dhe do të forcojnë karakterin turistik të tij. Përtej këtij aspekti ai do të ndikojë dhe në rritjen e cilësisë mjedisore në zonë. Projekti jo vetëm do të ofrojë një hapësirë rekreative të këndshme për qytetarët por do të permiresojë edhe imazhin turistik të zones. Qellimi i projektit është rehabilitimi dhe zhvillimi urban i fshatit turistik Zogaj.



7. Rikonstruksioni i rrugëve Fermentim (Ora e Maleve, Ardian Kodra, 12 Vjetori, Dëshmorët, Besa, Çlirimi) (Përfunduar)



8. Rikualifikimi i shtresave asfaltike për rrugët e qytetit dhe njërive administrative (Përfunduar)



Rrugët	Lagja/Nj. Administrative	Gjatesia (m)
Bulevardi Skenderbeg	Lagja 4	960
Rruga e Rushkullit	Dajç	780
Rruga e Varrezave katolike	Guri i Zi	760
Rruga Hysaj	Rrethina	630
Rruga Logorec, Frano Ilia	Guri i Zi	750
Rruga Rakaj	Rrethina	245
Rruga Snakej	Lagja 1	100
Rruga Todi Germenji, Udhëtari	Rrethina	2275

Rruga Trush Qender dhe Maksutaj	Berdice	1570
Rruga Alimetaj	Ana e Malit	1000
Rruga e Shkolles	Dajç	480
Rruga Morana e Pisha	Rrethina	1230
Rruga nr.5	Velipoje	435
Rruga Domnore	Guri i Zi	760
Rruga Gerbele	Velipoje	210
Rruga Llesh Viluni	Velipoje	500
Rruga Boks-Kullaj	Postribe	1580
Rruga e Drinit	Berdice	300
Rruga e Varrezave	Dajç	435
Rruga Lin Shkreli	Lagja 3	180
Rruga Muja	Rrethina	110
Rruga Velinaj	Ana e Malit	500
Rruga Vejukej	Ana e Malit	400
Rruga Mark Sadiku	Rrethina	1080
Rruga 7 Shaljanet(degezim)	Lagja 5	70
Rruga e Pularise	Berdice	340
Rruga Don Bosko	Lagja 4	330
Rruga e Rragamit	Guri i Zi	30
Rruga e varrezave te qytetit	Rrethina	460
	TOTALI	18,500

9. Rikualifikimi i shtresave asfaltike për rrugët e qytetit dhe njësive administrative (Në Proces)

Në vijim të proceseve të degjesave publike si dhe sipas evidentimeve të administratoreve të njësive adminsitrativë dhe lagjeve janë identifikuar nevojat specifike për investime në të gjitha zonat e duke bërë një ndarje mes investimeve që duhet të realizohen të plota (KUB, KUZ, etj.) dhe atyre investimeve për të cilat do të bashkëpunohet me FSHZH për shtresa asfaltike për të vijuar në rikualifikimet dhe ndërtimet e infrastrukturës rrugore.



10. Rikonstruktion Rrugët Mar Lula (Roza Lejn dhe Degëzime) (Në Proces)



11. Ndërtim i rrjetit Ujësllës Mar Lula (Në Proces)

Projekt i cili së bashku me rikualifikimin rrugëve Roza Lejn dhe Degëzime integron në shërbimet publike një zonë dhe bllok banimesh e cila në vite është konsideruar informale dhe tanimë bëhet pjesë integrale e qytetit.



12. Selim Coba (Në Proces)



13. Rikonstruktion Rruga Vekshar (Në Proces)



14. Rikualifikim urban “Martin Camaj” (Në Proces)



15. Rikualifikim urban Rruga "Tafilicëve" (Në Proces)



16. Rruga "Bregu i detit", Velipoje (Në Proces)



17. Rruga "Fshati Golem" (Përfunduar)



18. Rruga "Pjetrushi" (Grudë e Re) (Në Projes)



19. Rikualifikim Blloqe pallatesh (Çakej dhe Koplikej)

Pas sistemimeve të hapësirave publike në brendësi të lagjeve të qytetit është e nevojshme vijimi i punës për rikualifikimet e këtyre blloqeve pallatesh duke krijuar sheshe publike funksionale.



Blloku Çakej



Blloku Koplikej

20. Rikonstruksion rrugësh në Qytet

Përgjatë vitit 2026 janë planifikuar ndërhyrje rikualifikuese në rrugët e qytetit sipas dëgjësave publike dhe evidentimeve përkatëse duke shpërndarë investimet në secilën lagje të qytetit:

- *Rruga Leke Dukagjini*
- *Rruga Komanej*
- *Rruga Luigj Benusi*
- *Rruga Edit'h Durham*
- *Rruga Frang Bardhi*
- *Rruga Dora D'Istria*

- *Degezim Rruga Tepe (Qafehardhi)*

21. Rikonstruktion rrugësh në Njësi Administrative

Përgjatë vitit 2026 janë planifikuar ndërhyrje rikualifikuese në rrugët e Njësive Administrative sipas dëgjesave publike dhe evidentimeve përkatëse duke shpërndarë investimet në secilën Njësi:

- *NJA Ana Mali* *Rruga Dodaj-Shtuf*
- *NJA Dajc* *Rruga e Varrezave në fshatin Rrushkull*
- *NJA Rrethina* *Rruga Isa Jakupi, Dobrac (Faza I)*
- *NJA Berdice* *Rr. Muhaj, Rruga e Ballamanit*
- *NJA Postribe* *Rruga Fshati i Ri (Faza I)*
- *NJA Guri i Zi* *Rruga e Varrezave, Furracak, Trotuari Guri I Zi*
- *NJA Velipoje* *Rruga Prekaj dhe Luiz Ndoci (Faza I)*


22. Rikualifikimi i Lagjes Tregtare Zdrale (Në Proces)



23. Rikualifikimi i lagjes tregtare Zdrale Faza II (Në Proces)



24. Ndërhyrje në termoizolimimin e pallateve Blloku Perash, Ura Dervishbeg dhe Sarreq (Përfunduar)



25. Termoizolimi i pallateve. (Në Proces)

Përgjatë vitit 2026 do të vijohet me bashkëpunimin e FSHZH termoizolimi i pallateve me kapotë duke siguruar efikasitet të energjie, komfort dhe cilësi të mirë jetese për banorët.



26. Termoizolim i Godinave Publike. (Në Proces)


Me bashkëpunimin e Agjencisë së Eficiencës së Energjisë do të vijohet me punën për termoizolim të godinave publike.

Agjencia e Eficiences se Energjise	
1	Bibloteka "Marlin Barleti "
2	Qendra kulturore e femijeve "Kujtim Alija"
3	Godina e Shtepise Femijeve 0-5 vjec
4	Godine e shtepise Femijeve 6-15 vjec
5	Godina e Qendres se Zhvillimit rezidencial Shkoder
6	Qendra Rinore Atelie + Galeria e Arteve+ QK " Pjeter Gaci
7	Konvikti Shkolles se Muzikes "Prenk Jakova" Shkoder
8	Çerdhja "1 Maji" (Drejtoria e Kopshteve dhe Cerdheve)
9	Kopshti "Bep Tusha "
10	Kopshti "Tom Alimhilli", Shkoder
11	Kopshti "Ismet Sali Bruçaj", Shkoder
12	Kopshti & Çerdhe Guerrile "Ngjyrat"
13	Qendra Komunitare Multifunkionale "Për Familjen", Shkoder
14	Qendra Komunitare Multifunkionale "Për Familjen" nr 5

PAMJA KRYESORE SHK.1-100



PAMJA NGA MBRAPA SHK.1-100



27. Termoizolimi i bllokut të banimit Pallati me Hark pranë Isa Boletini (Në Proces)



28. Rikualifikim i Godinës së Merkatës Rus. (Në Proces)

Për vitin 2025 është në proces zbatimi i projektit Rikualifikimi i godinës së Markatës Rus. Ky projekt parashikon Rikualifikimin e godinës së Merkatës Rus duke ridimensionuar zonën për ta kthyer atë në një mjedis të përshtatshëm por edhe atraktiv, i cili do të ofrojë hapësira të nevojshme për tregtim të produkteve lokale duke e bërë me atraktiv frekuentimin e këtij tregu nga të gjithë banorët, por edhe vizitorët e shumtë si një atraksion i produktit lokal.



MERKATA E RUSIT

SHKODER, 2025


29. Rijetëzimi i Kinema “Republika” (Përfunduar)



30. Instalimi i sistemit ngrohës dhe ftohës në Teatrin “Migjeni” (Përfunduar)




31. Xhamia e Plumbit (Përfunduar)



32. Rikualifikimi i Shkollës “Kolë Idromeno” (Përfunduar)



33. Rikualifikimi i Shkollës “Ndre Mjeda” (Përfunduar)



34. Ndërtimi i Fushës sportive “Dëshmorët e Prishtinës” (Përfunduar)



35. Ndërtimi i Fushës Sportive “Xheladin Fishta” (Përfunduar)



36. Rikonstruktion Shkolla “Ismail Qemali” (Në Proces)



37. Rikonstruktion Kopshti “Ton Alimhilli” (Në Proces)



38. Rikonstruksion Kopshti “Bep Tusha” (Në Proce)



39. Ndërtim Palestre Shkolla “28 Nëntori” (Në Proce)




40. Ndërtim Fushe Sportive Shkolla “Tring Smajli” (Në Proce)




41. Bashki me Energji Inteligjente – Financim i projekteve të ndriçimit (Rruga Lin Delija, Rruga Qemal Draqini) (Përfunduar)



42. Rikonstruksioni i Kanaleve Kulluese KU10 Gur i Zi, KU22-23, KU32-33 Bërdicë (Përfunduar)



43. Reduktimi i pasojave të përmytjes – Kolektori i Qytetit (Në Proces)



44. Ndërtimi i InfoPoint (Në Proces)



45. Projekti “Dua të Luaj” (Në Proces)



46. Projekti “A Luajmë Bashkë” (Në Proces)



47. Kuartieri i Muzeve (Në Proces)



Ndërhyrja e propozuar

Muzeu i Qytetit në ndërtesën e Bashkisë

Muzeu i Arteve në godinën e Prefekturës

Muzeu i arkitekturës tradicionale në Shtëpinë Oso Kuka

QKF si godinë e re

Parku & Rr. 03 Dhjetori - Park arti dhe eventesh

48. Muzeu i Navigimit (Në Proces)



49. Muzeu i Dëshmisë dhe Kujtesës

The site is organized into four zones, each representing a different aspect of the program: The Prison, The Museum, The Memorial, and The Education-Research Center.

1. THE PRISON

The Prison remains at the center of the courtyard and should be restored to its original appearance when it was in use. Certain parts of the building, such as the window of the deaf guardian that is currently closed with bricks, can be restored to their original state to serve as part of the interpretation of the site. Every small detail, such as marks on the walls, needs to be preserved without any visual interference.

2. THE MEMORIAL


The memorial is a small, public, and open room located between the entrance building and the prison. It functions as an empty void in the urban structure that symbolizes the feeling of loss. It is accessible via a narrow alley that leads to an elliptical space. This space serves as the focal point around which the museum is articulated.

3. THE MUSEUM

The museum surrounds the memorial, connecting the current entrance building to the prison. It is composed of elliptical walls that echo the design of the memorial.

4. THE EDUCATION AND RESEARCH CENTER


The Education-Research Center is situated within the renewed entrance building, which is more accessible for visitors and researchers and does not require an entrance fee.



- 1. PRISON
- 2. MEMORIAL
- 3. MUSEUM
- 4. EDUCATION & RESEARCH

50. Rijetëzimi i Kalasë “Rozafa” (Në Proces)

- ✓ Transformimi i kodrës në parkun e Rozafës
- ✓ Aksese të reja që lidhin kalanë me atraksionet përreth
- ✓ Akses direkt nga Parku i Bunës në Kalanë Rozafa
- ✓ Nivele të ndryshme aksesueshmërie për në kala.
- ✓ Piacë publike me pikat panoramike
- ✓ Transformimi në një atraksion rajonal



II. Shkodra dhe Projektet Afatgjata:



BASHKIA
SHKODËR


Zbatimi i projekteve të mëdha të infrastrukturës të cilët kërkojnë mbështetje financiare nga Qeveria dhe BE për Shkodrën Kryeqëndër Rajonale:

1. Autostrada Adriatiko–Joniane, me gjatësi 40 km dhe me vlerë totale të investimit €423 mln.
2. Aksi Milot – Balldre me vlerë totale e investimit €364 mln.
3. Bypassi Lindor Ura e Re mbi Drin dhe Kir, me vlerë totale e investimit: €100mln.
4. Stacioni Hekurudhor dhe Hekurudha Vorë–Hani i Hotit, me gjatësi 120 km dhe me vlerë totale të investimit €370 mln.
5. Hekurudha Shkodër–Gjakovë me gjatësi 95 km.
6. Aksi Shirokë-Zogaj-Kufi me gjatësi 6.5 km dhe me vlerë totale të investimit €4.7 mln.
7. Aksi Dukagjin me gjatësi 47 km.

1. Autostrada Adriatiko–Joniane, Rruga Muriqan-Balldre ËBIF

Shkodra është një portë e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor dhe një nyje e rëndësishme transporti. Në këtë kuadër, Bashkia Shkodër vijon bashkëpunimin me Ministrinë e Infrastrukturës për realizimin e projekt Muriqan – Balldre pjesë e Korridorit Adriatiko – Jonian.

Projekti ka shtrirje në territorin e Bashkisë Shkodër dhe do të japë një impakt të rëndësishëm në zhvillimin e rrjetit të transportit duke ndikuar, veçanërisht, në përmirësimin e transportit në zonat me flukse të larta turistike.



BUNA BRIDGE

TYPE: EXTRADOSED (CANTILEVER) BRIDGE	LOCATION: CH. 8+040 – 8+520	TOTAL LENGTH: 480M	TOTAL DECK WIDTH: 29.50M	SPANS: 140M + 200M + 140M
CLEARANCE HEIGHT: 12.2M OVER THE RIVER SURFACE	CLEARANCE WIDTH: 76M	HORIZONTAL CURVE RADIUS: 1 200M	VERTICAL CURVATURE RADIUS: 23 000M	CROSS FALL: 5.00%



BEFORE



AFTER

2. Aksi Milot – Balldre

Autostrada e re Milot-Balldren do të jetë një autostradë e kategorisë A, cilësia më e lartë e rrugëve të standardit europian. Ajo fillon tek kryqëzimi i Rrugës së Kombit në Milot dhe përfundon në afërsi të fshatit Balldre, në dalje të qytetit të Lezhës, në rrugën që të çon në Shkodër. Kjo autostradë do të ketë një gjatësi prej 17 km duke dhënë një impakt direkt në lehtësimin e trafikut në rrugën Shkodër – Lezhë.



3. Bypassi Lindor Ura e Re mbi Drin dhe Kir.

Ndërtimi i Bypass-it Lindor të qytetit të Shkodrës përfaqëson një ndër projektet më strategjike për zhvillimin urban dhe ekonomik të qytetit. Ky projekt synon të krijojë një korridor të ri lëvizjeje, i cili do të ofrojë një zgjidhje afatgjatë dhe të qëndrueshme për problematikat e trafikut, qarkullimit dhe aksesit në territor. Aktualisht, qendra dhe akset

kryesore të Shkodrës mbartin një ngarkesë të madhe trafiku, veçanërisht nga mjetet që lëvizin drejt zonës industriale, si edhe nga flukset ndërkufitare të transportit mes Shqipërisë dhe Malit të Zi. Me realizimin e Bypass-it Lindor pritet të arrihen përfitimet kryesore si:

- Përmirësimi i qarkullimit të brendshëm përmes krijimit të një rruge alternative që redukton ngarkesën në akset ekzistuese;
- Rritja e aksesit me zonën industriale dhe ekonomike të Shkodrës, duke favorizuar bizneset dhe lehtësuar transportin e mallrave;
- Krijimi i lidhjes optimale me pikën kufitare me Malin e Zi, duke përmirësuar qarkullimin ndërkombëtar dhe duke rritur potencialin turistik e tregtar të qytetit;
- Rritja e sigurisë rrugore, për shkak të devijimit të mjeteve të rënda jashtë zonave të banuara;
- Kontribut në zhvillimin urban, duke hapur mundësi të reja për zgjerimin e infrastrukturës, zonave të reja zhvillimore dhe shfrytëzimin më efikas të territorit.

Bypass-i Lindor është konceptuar si një aks modern, i projektuar sipas standardeve bashkëkohore të sigurisë dhe qarkullimit, me shtresa cilësore asfaltimi, elementë mbrojtës, sinjalistikë vertikale dhe horizontale, si dhe mundësinë e lidhjes me nyje të rëndësishme hyrëse-dalëse të qytetit.



4. **Stacioni Hekurudhor dhe Hekurudha Vorë–Hani i Hotit**


“Rehabilitimi i linjës hekurudhore Vorë – Hani i Hotit” përbën një prej projekteve strategjike më të rëndësishme në sektorin e transportit hekurudhor, nga i cili Bashkia Shkodër rezulton përfituese direkte. Projekti është pjesë përbërëse e zgjatimit të Rrjetit Kryesor të Transportit Trans-Europian (TEN-T) në Ballkanin Perëndimor dhe synon integrimin e Shqipërisë në rrjetet hekurudhore rajonale dhe ato europiane përmes

Korridorit Paneuropian X. Ky investim shtrihet përgjatë linjës ekzistuese hekurudhore Vorë – Hani i Hotit, me një gjatësi totale prej rreth 120 kilometrash, duke ndjekur ultësirën perëndimore të vendit nga jugu drejt veriut. Hekurudha lidh një sërë qendrash urbane dhe ekonomike, përfshirë Vorën, Mamurras, Laçin, Milotin, Lezhën, Shkodrën dhe Koplikun, deri në pikën kufitare me Malin e Zi në Hanin e Hotit.

Edhe pse gjurma aktuale është funksionale, projekt-rehabilitimi parashikon modernizimin e saj tërësor për të siguruar standarde bashkëkohore të sigurisë, shpejtësisë dhe efikasitetit. Përfitimet e projektit janë të konsiderueshme, si në aspektin ekonomik ashtu edhe në atë social e mjedisor. Rehabilitimi i linjës do të mundësojë:

- Rritjen e ndjeshme të cilësisë së transportit të mallrave dhe pasagjerëve;
- Integrimin e qytetit të Shkodrës në rrjetin hekurudhor rajonal dhe europian;
- Uljen e kostove të transportit dhe rritjen e efikasitetit logjistik për bizneset;
- Zgjerimin e mundësive për zhvillim turistik;
- Reduktimin e trafikut rrugor dhe ndotjes mjedisore;
- Përmirësimin e sigurisë së lëvizjes.





5. Hekurudha Shkodër - Gjakovë

Financimi për ndërtimin e hekurudhës Shkodër – Gjakovë pritet të sigurohet përmes një kombinimi instrumentesh, duke përfshirë financime nga donatorë të ndryshëm, si dhe kontribute kombëtare nga Shqipëria dhe Kosova. Sipas studimit të fizibilitetit kostot për këtë segment hekurudhor përlogariten në 1.8 mld euro. Rreth 1.7 mld euro janë kosto që nevojiten për ndërtimin, ndërsa pjesa tjetër përlogariten si kosto për leje, shpronësime, etj. Linja hekurudhore nga Shkodra në Gjakovë do të ketë 7 stacione, në një gjatësi prej 105.8 km. Segmenti do të përmbajë 43 ura dhe 14 tunele, teksa gjatësia totale e tuneleve është 35.3 km. Pritshmëritë janë që kjo linjë të ketë një ndikim të ndjeshëm si në transportin e mallrave, ashtu edhe në lëvizjen e pasagjerëve.



6. Aksi Shirokë-Zogaj-Kufi

Punimet për rikonstruksionin e rrugës Shirokë – Zogaj (Pika e Kalimit Kufitar) po shkojnë drejt përfundimit, duke shënuar një transformim të rëndësishëm për një nga zonat më të

bukura të Shkodrës. Ky aks rrugor po kthehet në një hapësirë moderne dhe funksionale, me standarde bashkëkohore që rrisin cilësinë e jetës për banorët dhe atraktivitetin turistik të zonës.

Rruga do të ofrojë dy korsi të dedikuara për qarkullimin e mjeteve motorike, trotuar të gjerë dhe një pistë të veçantë biçikletash përgjatë gjithë vijës së liqenit, duke e bërë këtë shëtitje një nga më panoramike në vend. Projekti përfshin gjithashtu ndriçim të plotë rrugor me teknologji efikase dhe vendparkime të sistemuara, të cilat do të lehtësojnë qarkullimin dhe do të përmirësojnë ndjeshëm aksesin për banorët dhe vizitorët.

Me këtë investim, Shiroka dhe Zogaj marrin një lidhje më të sigurt, më të bukur dhe më funksionale, duke krijuar premisa të reja për zhvillimin e turizmit, sporteve në natyrë dhe biznesit lokal. Ky është një tjetër hap i rëndësishëm drejt zhvillimit të qëndrueshëm të zonës së Liqenit të Shkodrës.



7. Aksi i Dukagjinit – lidhja Lekbibaj

Në këtë aks rrugor mungon prej shumë vitesh ndërhyrja për përmirësimin e kushteve të infrastrukturës rrugore. Ky aks rrugor rezulton të ketë një dimension strategjik për zhvillimin e turizmit në rajonin e Shkodrës dhe Tropojës.

Përgjatë këtij segmenti rrugor konstatohet një gjendje jo e mirë e parametrave teknik, gjendje e degraduar e shtresave rrugore ekzistuese dhe gjerësi e vogël e rrugës. Rruga është e ngushtë, tërësisht e amortizuar, dhe me probleme serioze që cenojnë sigurinë e qarkullimit në këtë segment. Projekti konsiston në sistemimin, profilimin e rrugës si dhe vendosjen e tombinove dhe mureve mbajtës nga Fshati Prekal deri në hyrje të Fshatit Lotaj. Duke qenë se rruga ka pjerrësi gjatësore dhe kanalet anësore mungojnë, ujerat atmosferike kalojnë në rrugë duke dëmtuar e prishur trupin e rrugës.

Gjatë rikonicioneve janë identifikuar të gjitha veprat e artit dhe niveli i ndërhyrjes së tyre. Rehabilitimi i këtij aksi rrugor përmirëson në mënyrë të ndjeshme aksesin për rreth 20000 banorë të tre njësi administrative: Pult, Shalë dhe Shosh si dhe të zonave turistike (Parku Kombëtar i Thethit, luginën e Lumit Kir, Luginën e Lumit të Shalës gjithashtu dhe një numri të konsiderueshëm të monumenteve të kulturës dhe të monumenteve natyrore). Aksi përshkon të gjithë zonën e Dukagjinit dhe një degëzim në lindje të këtij aksi (Lotaj-Lekbibaj) lidh zonën dhe Shkodrën me Lekbibajt në Tropojë e në vijim me Bajram Currin, luginën e Valbonës dhe më tej Gjakovën në Kosovë. Ky aks i gjatë dhe i vështirë malor

është shumë i rëndësishëm për kompletimin e rrjetit rrugor të Alpeve në funksion të zhvillimit të turizmit.

